



RAPORTI
VJETOR
I GRUPIT

2023

Annual Group Report



Volumi i primeve (Euro)

Group	112,398,000
AL	64,790,000
KS	21,383,000
MKV	26,224,000

Nr. i zyrave

Group	2,128
AL	1,570
KS	114
MKV	444

Nr. i kontratave

Group	1,402,880
AL	477,602
KS	189,815
MKV	735,463

Agjentë dhe punonjës

Group	2,724
AL	1,806
KS	237
MKV	681

Përmbajtja

FJALA PËRSHËNDETËSE

- ANDREAS BRANDSTETTER, CEO UNIQA INSURANCE GROUP
- AVNI PONARI, CEO SIGAL UNIQA SHQIPËRI, KOSOVË, MAQEDONI E VERIUT

RRITJE E QËNDRUESHME, HARTA E GRUPIT

MISIONI YNË

VLERAT DHE PARIMET TONA UDHËZUESE

BORDI MBIKËQYRËS

KUSH ËSHTË SIGAL UNIQA

STRUKTURA E GRUPIT

KUSH ËSHTË UNIQA INSURANCE GROUP

NGJARJET KRYESORE

VLERËSIME KOMBËTARE DH
NDËRKOMBËTARE

PËRGJEGJËSI SOCIALE

EKIPI I SIGAL UNIQA

RISI DHE NOVACION

MEDIA

TË DHËNA PËR TREGUN E SIGURIMEVE NË
RAJON

TË DHËNA FINANCIARE

RAPORTI I AUDITITUESVE TË PAVARUR

RAPORTI I AUDITIT TË BRENDSHËM

RAPORTI I VLERËSIMIT TË RREZIKUT

OBJEKTIVAT 2024

STRUKTURA ORGANIZATIKE

KONTAKTE

Jetojmë më mirë së bashku

Ne nuk duam që t'ju mërzisim me raportin e vitit 2023, por thjeshtë duam t'ju japim një panoramë të asaj se çfarë kemi bërë, për ju klientë, për partnerët, për kolegët, për tregun dhe për komunitetin ku jetojmë dhe punojmë së bashku.

SIGAL UNIQA Group Austria vijojnë të jetë kompania më e madhe dhe më e besuar e sigurimeve në Shqipëri dhe rajon me të dhënat që tregojnë se jemi në rrugën e duhur.

E thënë ndryshe, primet dhe ta ardhurat janë rritur, gjithashtu edhe dëmet e paguara tek klientët.

“Jetojmë më mirë së bashku” nuk duhet të mbesë thjesht një moto, por të jetë e mbushur me veprime.

Lexim të këndshëm!



ANDREAS BRANDSTETTER
CEO, Uniqa Insurance Group

**U japim siguri
rreth 17 milionë
njerëz në Austri
dhe pothuajse të
gjithë Evropën
Juglindore**

Të nderuar zonja dhe zotërinj,
Të nderuar partnerë,

“

Industria evropiane e sigurimeve është investitori më i madh i kontinentit. Qoftë kriza klimatike apo sistemi i kujdesit shëndetësor: kompanitë e sigurimeve si UNIQA kanë shumë mundësi për të vendosur drejtimin në të cilin duhet të zhvillohet bota jonë.

Industria evropiane e sigurimeve menaxhon 11 trilion euro. Varësisht se ku do të drejtohen këto investime do të jetë vendimtare nëse BE do të ketë sukses në tranzicionin e gjelbër.

Në 10 vitet e ardhshme ne do të përjetojmë më shumë ndryshime sesa kanë ndodhur në 100 vitet e fundit. Për shembull, mbi 150 milionë euro në vit derdhen në fushat e inteligjencës artificiale, të dhënave të mëdha, IT, etj. Të gjitha fushat që na bëjnë të sigurt për të ardhmen.

“Shëndeti është në ADN-në tonë”.

Vështirë se ka një produkt më të bukur se ai që prodhojmë. Sepse ne u japim njerëzve siguri – rreth 17 milionë njerëz në Austri dhe pothuajse të gjithë Evropën Juglindore”

Andreas Brandstetter
CEO i “UNIQA Insurance Group AG”



AVNI PONARI
CEO i SIGAL UNIQA Group Austria,
Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut

“ 2023 ka qenë një vit sfidash të mëdha. Ka qenë një vit i rritjes të të ardhurave dhe primeve por ka qenë edhe një vit i ndërgjegjësimit të qytetarëve për të patur më shumë sigurime.

SIGAL UNIQA është në pozitat kryesuese në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Ajo zë vendin e parë në këto tri shtete dhe natyrisht mban vendin e parë edhe në pagesën e dëmeve.

Gjithmonë një hap para të tjerëve

Ne jemi më mirë se të tjerët. Jemi të parët! Edhe Kosova, edhe Maqedonia e Veriut dhe ne të gjithë si grup. Dhe llogaritemi mes 48 kompanive më të mëdhaja të Europës Juglindore. Çka na bën krenarë për punën që kemi bërë.

Gjithmonë kemi pasur si synim të kemi inovacione. Kemi qenë kërkues ndaj vetes. Kemi kërkuar që gjithçka ta bëjmë si duhet. Por idetë tona gjithmonë kanë qenë në konflikt me ata që zhvillojnë IT-në. Pavarësisht se ata janë shumë më lart por në zbatimin e ideve tona, programeve tona, ata nuk kanë arritur ti përgjigjen nivelit të kompanisë sonë. Dhe kjo kërkon më shumë punë për të ardhmen sepse sot industria e sigurimeve, ajo bankare dhe e financave në përgjithësi janë 100% të automatizuara. Duke i shërbyer më mirë klientit se në fund të fundit ky është qëllimi.

Në gjithë punën tonë jemi nisur nga disa parime dhe norma mbi të cilat kemi bërë për ndërtimin e strukturës së SIGAL-it, mbi bazën e departamenteve, në mënyrë që të jemi ndryshe nga ato që kanë kompanitë e tjera. Dhe kjo ka qenë e veçanta jonë.

Pse ne ecim më mirë se të tjerët?

Kemi një brand të besuar, kemi një emër të besuar. Edhe ata me të cilët bashkëpunojmë janë ndër emrat më të rëndësishëm në Europë. Produktet më të mira. Kemi qenë lider. Ne kemi nxjerrë një produkt, tregjet kanë ardhur pas nesh. Kemi qenë gjithmonë përpara, në të gjitha produktet.

”

Avni Ponari, CEO i SIGAL UNIQA Group Austria, Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut

Rritje e qëndrueshme në Austri dhe në Europën Qendrore-Lindore

Më shumë se 16.7 milionë klientë në Austri dhe Europën Qendrore i besojnë shërbimit të klasit të parë të Grupit UNIQA. Qëllimi ynë ambicioz: të jemi ofruesi më i mirë i shërbimit në të dy tregjet dhe të marrim një vlerësim prej të paktën 4.5 nga 5 yje nga klientët tanë.


Për mbi 200 vjet ne kemi qenë të suksesshëm në biznesin e sigurimeve dhe në tregun tonë vendas të Austrisë jemi një nga ofruesit kryesorë në këtë sektor. Në tregun tonë të dytë kryesor, rajonin e Europës Qendrore dhe Lindore, ne kemi qenë në gjendje të forcojmë ndjeshëm pozicionin tonë në treg gjatë viteve të fundit përmes integritimit të ish-kompanive AXA në Poloni, Sllovaki dhe Çeki. Grupi UNIQA vazhdon të fokusohet në rritjen fitimprurëse pavarësisht sfidave ekonomike.

16.7
milionë klientë
në 17 shtete

3.7
milionë klientë
në Austri

8.5
milionë klientë
në Europën
Qendrore

4.5
milionë klientë në
Europën Lindore,
Juglindore dhe
Lihtenshtein



● Europa Qendrore (EQ)
● Europa Lindore (EL)
● Europa Juglindore (EJL)

Etiketa në çdo shtet tregon pozicionin e kompanisë në tregun përkatës.

Misioni ynë

Një kompani shqiptare me standarde evropiane si SIGAL UNIQA Group AUSTRIA e ka të qartë misionin e saj: të paguajë në kohë rekord dëmet dhe të mbrojë qytetarët mbi bazën e kontratave të sigurimit.

Përgjatë 24 viteve punë, SIGAL UNIQA si Grup ka paguar më shumë se 400 milionë euro dëme, shifër kjo që tregon qartë seriozitetin, qëndrueshmërinë financiare dhe përgjegjshmërinë ndaj klientëve të saj.

Vetëm për dy tërmetet e fundvitit 2019, SIGAL UNIQA ka paguar afro 20 milionë euro dëme për klientët e saj.

Krahas përgjegjshmërisë kontraktuale, SIGAL UNIQA ka dëshmuar përkujdesje maksimale për komunitetin, duke kontribuar në shëndet, art, kulturë, trashëgimi kulturore, sport, turizëm dhe arsim me miliona euro

ndër vite.

Vepra të tilla si rikonstruksioni i Teatrit Skampa në Elbasan pas djegies totale, rikonstruksioni i Kinema Millenium Korçë, rikonstruksioni i shtëpisë muze në Korçë e Berat, rikonstruksion shkollash dhe pajisje me mjete shkollore, të gjitha këto mbajnë emrin SIGAL UNIQA.

Sepse e tillë duhet të jetë një kompani, e cila jo vetëm të marrë por edhe duhet t'i japë mbrapsht komunitetit, nëpërmjet investimeve në fusha të ndryshme. Kjo ka qenë motoja jonë si SIGAL UNIQA që prej fillimit dhe do të vazhdojë të jetë edhe për të ardhmen.

Sepse ne besojmë që zhvillimi jonë shkon krah për krah me zhvillimin e shoqërisë dhe ekonomisë së vendit tonë.

Parimet dhe vlerat tona udhëzuese



Bordi Mbikëqyrës



Andreas Brandstetter
Kryetar i Bordit Mbikëqyrës, SIGAL UNIQA
CEO i UNIQA Insurance Group




Wolfgang Kindl
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës,
SIGAL UNIQA



Gerald Mueller
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës,
SIGAL UNIQA



Georgios Bartzis
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës,
SIGAL UNIQA



Vinzenz Benedikt
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës,
SIGAL UNIQA

Kush është "SIGAL UNIQA"?

SIGAL UNIQA Group Austria është një prej grupeve më të mëdha të sigurimeve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

Kompania kryeson tregun e sigurimeve prej vitit 2002, duke zënë rreth 30% të tij në Sigurimet e Jetës, Jo-Jetës dhe Pensionit Privat.

E themeluar në Shkurt 1999, SIGAL UNIQA operon suksesshëm në të trija shtetet përmes 8 kompanive të saj: 3 Sigurime Jo-Jetë, 3 Sigurime Jete, 1 kompani risigurimi dhe 1 Fond Pensioni Privat.

Që prej marit 2007, ajo është pjesë e "UNIQA Insurance Group", një prej emrave më të njohur të sigurimeve dhe financave në Austri dhe Evropë, e shtrirë në 17 shtete të ndryshme, që numëron rreth 17 milionë klientë dhe është vlerësuar së fundmi nga "Standard & Poor's" me "A".

Portofoli i SIGAL UNIQA Group Austria është i risiguruar në tregjet më të mëdha botërore teksa kompania bashkëpunon me emra të mëdhenj si: 'UNIQA Re', 'Munich Re' apo 'Hannover' Re duke ofruar një garanci më shumë për mbi 1.2 milion klientët e saj.

Ritmet e progresit të SIGAL UNIQA kanë bërë që shumë publikime profesionale në fushën e sigurimeve ta vlerësojnë atë me shumë çmime dhe vlerësime.



Nr. 1
në tregun e sigurimeve



1.2 milionë
klientë



3 shtete
AL - KS - MKV



Bordi Drejtues i Grupit SIGAL UNIQA

(Nga e majta në të djathtë) Saimir Dharmo (CEO i SIGAL UNIQA Group Austria Kosova), Alma Totokoçi (Zv. Drejtore e Përgjithshme e SIGAL UNIQA Group Austria), Avni Ponari (CEO i Grupit SIGAL UNIQA Group Austria), Edvin Hoxhaj (Drejtor i Përgjithshëm i SIGAL Life UNIQA Group Austria), Driton Azizi (Drejtor i Përgjithshëm i UNIQA Maqedoni e Veriut) dhe Elvis Ponari (Administrator i Përgjithshëm i Fondi të Pensioneve Vullnetare SIGAL Life UNIQA Group Austria)

Struktura e Grupit SIGAL UNIQA

Shqipëri

SIGAL UNIQA Jo Jetë
dhe Risigurime

SIGAL Life UNIQA

Fondi i Pensionit Vullnetar
SIGAL Life UNIQA

Kosovë

SIGAL UNIQA
Jo Jetë

SIGAL Life UNIQA

Maqedoni e Veriut

UNIQA Jo Jetë

UNIQA Life

86.9%

UNIQA Insurance Group

Aksionerët
tanë


13.1%

Investitorë vendas

Kush është “UNIQA Insurance Group”?

Grupi UNIQA është një nga kompanitë kryesore të sigurimeve në tregjet e tij kryesore të Austrisë dhe Evropës Qendrore dhe Lindore (EQL). Rreth 21,000 punonjës dhe partnerë ekskluzivë të shitjeve u shërbejnë pothuajse 17 milionë klientëve në 17 vende. UNIQA është grupi i dytë më i madh i sigurimeve në Austri me një pjesë tregu prej rreth 21 për qind. Në rajonin e rritjes së EQL-së, UNIQA është e pranishme në 14 tregje: Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Çeki, Hungari, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut, Poloni, Rumani, Serbi, Sllovaki dhe Ukrainë. Përveç kësaj, kompanitë e sigurimeve në Zvicër dhe Lihtenshtajn janë gjithashtu pjesë e Grupit UNIQA.

Shpërndarja e portofolit ...



... në tregjet kryesore në Austri dhe EQL



Shpërndarja primeve

UNIQA Group

[@UNIQA Insurance Group](#) [@uniqagroup](#) [@uniqa](#)

UNIQA Austria

[@uniqa.at](#) [@uniqa.at](#)

Për një të ardhme të qëndrueshme

I gjithë Grupi UNIQA, neutral ndaj klimës deri në vitin 2050

“UNIQA Insurance Group”, prezente në Shqipëri dhe rajon përmes Grupit “SIGAL UNIQA”, është thellësisht e përkushtuar ndaj objektivit 1.5 gradë të Marrëveshjes së Parisit për Klimën.

Gjigandi i sigurimeve synon të jetë neutrale ndaj klimës deri në vitin 2040 në Austri dhe në Evropën Qëndrore dhe Lindore deri në vitin 2050.

“Ne kemi hyrë në partneritete strategjike kyçe me rrjetet kryesore të klimës dhe kemi marrë përsipër detyrime gjithëpërfshirëse të raportimit. Qëndrueshmëria është një pjesë thelbësore e programit tonë të ardhshëm UNIQA 3.0 dhe për këtë arsye është bërë një kriter i panegociueshëm në biznesin tonë. Së bashku me punonjësit tanë, klientët tanë dhe palët e tjera të interesuara mund të japim një kontribut efektiv për një jetë më të mirë dhe një botë më të mirë”, thonë nga “UNIQA”.

Strategjia dhe Qeverisja

“UNIQA” shqyrton me kujdes kushtet e kornizës që beson se janë të favorshme për një jetë më të mirë. Për ta bërë këtë, ajo merr pjesë në diskutime, ndan perspektivat e saj dhe përfshihet në mënyrë që qëndrueshmëria të bëhet pjesë qendrore e veprimeve të saj.

“Me qëndrimin tonë të qartë, ne gjenerojmë mirëkuptim dhe mbështetje nga të gjithë aktorët tanë”, thotë kompania me seli qendrore në Vjenë.

ENERGJI E GJELBËRT

“UNIQA” po ndërmerr veprimet e duhura në sa i përket kujdesit ndaj mjedisit. Vënia në punë e sistemit të ri fotovoltaik në çatinë e selisë qendrore të UNIQA në verën e vitit 2023, më i madhi ndonjëherë në një ndërtesë kompanie, është një moment historik. Falë fuqisë së tij prej 125 kWp, ai do të jetë në gjendje të prodhojë 100,000 kWh energji elektrike në vit. Kjo korrespondon me konsumin vjetor të rreth 30 familjeve dhe shmang kështu emetimet e rreth 21 tonë dioksidi karboni (CO₂).

“UNIQA” ka rritur prodhimin e saj fotovoltaik të instaluar nga 50 kWp në mbi 400 kWp që nga viti 2020, një rritje 8-fish në vetëm pak vite. Deri në vitin 2035, prodhimi fotovoltaik duhet të jetë së paku 600 kWp.

Gjithashtu, kompania ka blerë 100% energji elektrike të gjelbër prej vitesh në Austri. Nga viti 2024 e në vazhdim do të blihet vetëm energji elektrike “green” e certifikuar me Eco-label Austriak 46 (UZ 46 “Green Electricity”).

**NGJARJET
KRYESORE
2023**

16 vjet UNIQA në Shqipëri Një markë, shumë gjuhë por të bashkuar nën një moto: “jetojmë më mirë së bashku”



“UNIQA” ishte dallëndyshja e parë nga Europa që vendosi të investojë në tregun financiar shqiptar dhe atë të rajonit dhe sot është më e besuara në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

23 mars 2007 ishte data do të shenjonte një moment shumë të rëndësishëm në jetën ekonomike dhe financiare të vendit por edhe të tregut të sigurimeve në veçanti: partneriteti SIGAL – UNIQA Insurance Group.

Sot, 16 vite pas kësaj ngjarjeje të rëndësishme për jetën financiare të vendit, themeluesi dhe Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA, z. Avni Ponari shprehet i lumtur për vendimin e marrë.

“Në 2007-ën filluan negociatat me “UNIQA-n”, një kompani e madhe dhe me shumë përvojë në sigurime. Ky bashkëpun-

im na krijoi akoma më shumë hapësira sepse ndihma e tyre ishte më e specializuar, si një kompani me 200 vite eksperiencë. U bëmë pjesë e strukturave më të gjera europiane dhe eksperiencat e të gjitha vendeve bashkoheshin me eksperiencën tonë dhe i ndanim me njëri-tjetrin, duke ndërtuar një strukturë të domosdoshme në vend. Sot SIGAL UNIQA është më i konsoliduar dhe nga 5 veta që punonin për ne në '99-ën, sot janë 2000 punonjës në 3 shtete, duke qenë një nga kompanitë më të mëdha në Europën Lindore dhe një nga kompanitë me pozicion të rëndësishëm renditjeje”, shprehet z. Ponari.

RISITË DHE NOVACIONI QË SOLLI UNIQA NË SHQIPËRI DHE RAJON

Shqipëria ka patur shumë investime të huaja pas viteve '90, por janë të pakta kompanitë e

huaja që kanë patur një efekt kaq të rëndësishëm tek sektori ku kanë investuar por edhe tek vetë qytetarët shqiptarë.

Një prej tyre është padyshim edhe "UNIQA Insurance Group", gjigandi austriak i sigurimeve, i cili falë eksperiencës mbi 200-vjeçare solli në Shqipëri produkte Sigurimi novatore që vijojnë edhe sot pas 16 vjetësh të jenë ndër më të suksesshmet për tregun shqiptar të sigurimeve, të cilat u mundësojnë klientëve shërbime më të mira, më të shpejta dhe në koherencë me zhvillimin e teknologjisë.

Këtu mund të përmendim aplikacionin "TeleShëndet" shërbimin e Asistencës Rrugore, "SIGAL UNIQA AutoSOS" apo së fundmi edhe siguracioni dedikuar vetëm sëmundjeve kancerogjene, "Sigurimi anti-Tumor"

Pa harruar edhe "SIGAL UNIQA Audio-books", platforma e parë dixhitale e librave në shqip. Kjo platformë synon promovimin e arsimit, kulturës dhe gjuhës shqipe. Ndërsa ndihmon edhe të verbërit dhe shqiptarët jashtë Shqipërisë që duan të lexojnë dhe tu mësojnë fëmijëve të tyre gjuhën shqipe.

Por një rol të rëndësishëm në politikën e kompanisë ka edhe përgjegjësia sociale, ndaj "SIGAL UNIQA Group Austria" është një emër që mund ta shihni përmes kontributeve të saj në sport, në art, në kulturë dhe në mbështetje të individëve apo grupeve të sukseseshme.

Emrin e kompanisë mund ta shihni në stadione, pallate sporti, koncerte, festivale, aktivitete bamirësie etj pasi prej vitesh "SIGAL UNIQA Group Austria" ka qenë një mbështetëse financiare e madhe e tyre.

E ARDHME E SIGURTË

Shumë vite zhvillim, qëndrueshmëri ekono-

mike dhe një staf profesional tregojnë se edhe prespektiva për të ardhmen do të jetë po kaq e mirë.

"Ne po shohim një zhvillim të shkëlqyer jo vetëm në Austri, por veçanërisht në kompanitë tona ndërkombëtare në Europën Qëndrore dhe Lindore. Me rreth 38% të primeve të shkruara dhe përfitim të shkëlqyeshëm, ato kontribuan ndjeshëm në rezultatet shumë të kënaqshme," thotë Brandstetter, duke theksuar orientimin ndërkombëtar të Grupit UNIQA.

"Sot, mbi 16 milionë klientë mbështeten tek ne për të mbrojtur dhe përmirësuar pronën e tyre, sigurinë financiare dhe kujdesin shëndetësor. Synimi ynë është t'i shoqërojmë dhe t'i mbështesim në çështjet shëndetësore si partnerë përkatës gjatë gjithë jetës së tyre", potencon z. Brandstetter.

Me një shtrirje të aktivitetit të saj në 18 shtete të ndryshme të Europës, ku fliten gjuhë të ndryshme, "UNIQA Insurance Group" është një komunitet që jeton dhe punon nëpërmjet diversitetit ku të 18 tregjet lidhen nën sloganin e përbashkët "jetojmë më mirë së bashku".

Por me qëllimin që motoja e Grupit të mos mbesë thjesht një premtim por të jetë e mbushur me veprime, mbi 2000 punonjësit e SIGAL UNIQA Group Austria në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut janë çdo ditë pranë mbi 1 milion klientëve jo vetëm për ti marrë primin por për të qenë pranë tyre atëherë kur ata kanë më shumë nevojë.

Ndaj dhe kompania, pavarësisht viteve që kalojnë dhe shtimit të aktorëve në treg, vijon të mbetet emri më i madh dhe i besuar i sigurimeve.

20 Vjet SIGAL UNIQA në Kosovë, 20 Vjet histori sukcesi

SIGAL UNIQA Group Austria – Kosovë kremtoi 20-vjetorin e themelimit të saj.



Në një event të organizuar në kryeqytetin Prishtinë me pjesëmarrjen e drejtuesve të kompanisë, autoriteteve vendase dhe qindra të ftuarve të tjerë, kompania lider në tregun e sigurimeve festoi ditëlindjes e saj të 20-të.

Një rrugëtim i vështirë, i mbushur me plot sfida por në të njëjtën kohë i suksesshëm teksa tani shohim që SIGAL UNIQA Group Austria është një emër që ka shenjuar historinë e sipërmarrjes së lirë në Kosovë, njësoj si në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut dhe adresa e parë për çdokënd që do të sigurojë jetën, shëndetin, pronën, automjetin dhe çdo gjë tjetër me vlerë.

Gjatë fjalës së tij, themeluesi dhe drejtuesi i Grupit "SIGAL UNIQA" në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, z. Avni Ponari u shpreh ndër të tjera se këto dy dekada kanë kaluar shumë shpejt por mbartin brenda tyre mijëra orë pune, mendimesh, idesh ndaj dhe sot kompania është lidere në tregun e sigurimeve, jo vetëm në Kosovë.

"Për 20 vite qëndrueshmëri dhe punë efektive, Ponari tha se janë investuar mbi 12 milionë euro në Kosovë.

Në këto 20 vite ne në Kosovë kemi investuar 12.5 milionë euro, kemi bërë një xhiro në total rreth 202 milionë euro, kemi paguar mbi 100 milionë euro dëme, dhe natyrisht që pjesa më e vogël është pjesa e fitimit të

aksionarëve dhe kompanisë, devidenti i tyre në 20 vjet është shumë i vogël, pra, çdo gjë e bëmë në investim dhe interes të ngritjes së kompanisë në Kosovë

Shpresojmë që nga kjo ditë, ta quajmë si dita e fillimit, dhe ta mendojmë këtë kompani si biznes i tashmes", tha ndër të tjera z.Ponari duke falenderuar stafin e punonjësve për punën e kryer gjatë këtyre viteve dhe klientët për besimin e dhënë", u shpreh CEO i SIGAL UNIQA Group Austria.

Por në një ngjarje kaq të rëndësishme për SIGAL UNIQA – Kosovë nuk mund të mungonte përshëndetja e CEO-s të "UNIQA Insurance Group", njëherazi aksionere kryesore e Grupit, z. Andreas Brandstetter.

Në video-mesazhin dërguar, z. Brandstetter, teksa uroi ditëlindjen e 20-të të SIGAL UNIQA në Kosovë, u shpreh ndër të tjera se, misioni i kompanisë që ai drejton është ofrimi i shërbimeve dhe produkteve të klasit të parë të më shumë se 16 milionë klientët tanë që UNIQA ka në thuajse të gjithë Europën.

Ndërkohë, duke qenë pjesë e Grupit më të madh të sigurimeve në Shqipëri dhe rajon, SIGAL UNIQA Group Austria, anëtarët e "SIGAL UNIQA Fond Pensioni" përfitojnë zbritje ekskluzive në klinikat dhe spitalet më të mira.



Zhvillohet në Valbonë Konferenca Vjetore e grupit SIGAL UNIQA

Grupi "SIGAL UNIQA" zhvilloi në ambientet e Hotel "Valbona" analizën vjetore 2023 dhe planin e punës për vitin 2024.

Në një hoteleve më elitare në Alpet Shqiptare, investim që i ka dhënë frymëmarrje një prej zonave më të bukura në Veri të vendit, nën drejtimin e CEO-s z.Avni Ponari dhe pjesëmarrjen e drejtuesve të kompanisë dhe departamenteve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut u analizua viti që po lemë pas, më i suksesshmi që prej vitit të themelimit, 1999.

"Të parët në prime, në pagimin e dëmeve dhe digjitalizim", tha ndër të tjera z.Ponari, i cili teksa u ndal te viti 2024, që përkon edhe me 25-vjetorin e SIGAL UNIQA Group Austria, tha ndër të tjera se, fokusi do të jetë në shitjen online të çdo produkti sigurimi, zhvillimin e aplikacionit për pagesën e dëmeve, gjë do të lehtësojë punën e stafit dhe do të jetë më pranë klientëve duke shmangur shumë burokraci-ra.

Grupi "SIGAL UNIQA" është i vendosur që, ashtu si gjatë vitit 2023, ashtu edhe gjatë vitit të ardhshëm të mbetet emri më i madh dhe më i besuar i sigurimeve, me më shumë novacion, me një portofol produktesh të digjitalizura dhe gjithmonë pranë mbi 1.2 milion klientëve.





“Lëvizim Green”/ SIGAL UNIQA me flotë makinash elektrike: Bashkë për një Shqipëri më të gjelbër

Urbanizimi i madh ka sjellë nevojën për të krijuar mënyra alternative lëvizjeje, për të ndikuar dhe në përmirësimin e cilësisë së ajrit.

Kompania më e madhe e sigurimeve, SIGAL UNIQA Group Austria ka ndërmarrë disa nisma “green”, më e fundit edhe blerja e një flote makinash elektrike, të cilat do të përdoren nga stafi.

Nisma më e re e kompanisë do të nisë nga Tirana dhe më pas do të shtrihet në të gjitha degët e SIGAL UNIQA në të gjithë Shqipërinë.

Nisma e kompanisë lider në sigurime duhet të jetë një frymëzim edhe për individët, komunitetet e ndryshme, bizneset dhe insti-

tucionet publike për t’iu bashkuar udhëtimit drejt një mënyre jetese më të gjelbër.

“Vëmendja ndaj nevojave të komuniteteve në të cilat ne operojmë dhe promovimi i iniciativave të përbashkëta ka qenë përherë një vlerë themelore e SIGAL UNIQA Group Austria.

Mbrojtja mjedisore është një nevojë parësore për kompaninë që drejtojmë.

Përgjegjësia Sociale është nga nga shtyllat kryesore të misionit të SIGAL UNIQA, kompani e orientuar drejt mbështetjes së kauzave të ndryshme sociale me impakt në komunitetin ku ushtron aktivitetin”, u shpreh ndër të tjera CEO dhe themeluesi i SIGAL UNIQA Group Austria, z. Avni Ponari.

Përmes kësaj politike, me bosht ekologjik, SIGAL UNIQA Group Austria synon të japë kontributin e saj në përmirësimin e cilësisë të shëndetit përmes zvogëlimit të ndikimit negativ të dioksidit të karbonit në atmosferë.

Së fundmi, keni licencuar edhe fondin e parë të investimeve.



Cilat janë objektivat dhe pritshmëritë tuaja nga fondi i investimeve Sigal Invest?

Obligacionet afatgjata të qeverisë ofrojnë flukse të besueshme të ardhurash, për shkak të një sërë arsyesh financiare, si mbrojtja nga luhajtjet e tregut të shkaktuara nga inflacioni dhe deflacioni, norma më të larta interesi krahasuar me llojet e tjera të letrave me vlerë të borxhit dhe likuiditet më të madh për shkak të kostove të ulëta të transaksioneve.

Përveç kësaj, ne u ofrojmë investitorëve akses shtesë në obligacione të shteteve europiane, të cilat përfaqësojnë strehë të sigurt për ata, që kërkojnë stabilitet, krahas mundësive potenciale afatgjata të rritjes së kapitalit, që vijnë së bashku me këto obligacione qeveritare.

Në SIGAL ne jemi shumë krenarë që mbajmë premtimin tonë, për të ofruar shërbime të jashtëzakonshme, duke siguruar norma konkurruese kthimi për investimet e klientëve tanë.

Angazhimi ynë ndaj këtij premtimi është provuar që nga viti 2006 kur hapëm, për herë të parë, Shoqërinë administruese e cila ka shërbuer për vite në rritjen e kursimeve nëpërmjet Fondit të Pensioneve SIGAL; duke ofruar paqe mendore nëpërmjet kontrolleve tona rigorozë të kryera në çdo hap të procesit, si dhe duke ofruar strategji të aftë të menaxhimit të portofolit të përshtatura rreth rrethanave individuale të secilit klient.

Përpiqemi që të gjithë klientët të përjetojnë transparencë në lidhje me progresin e investimeve të tyre në çdo kohë gjatë periudhës së investimit të zgjedhur, duke u siguruar që ata të ndihen gjithmonë të sigurt që fondet e tyre janë të sigurta me ne në SIGAL Investment Fund.

Për t'iu përgjigjur pyetjes, qëllimi ynë ka qenë gjithmonë t'ju ofrojmë klientëve dhe investitorëve tanë shërbim cilësor, siguri të lartë dhe kthim në investim të kënaqshëm.

Ne kemi nisur procedurat për hapjen e Fondit të Investimit që në fillim të vitit 2022 dhe atëherë pritshmëritë tona ishin të larta, duke parë që normat e interesit të Obligacioneve shtetërore premtinin rritje.

Në fund të vitit të kaluar dhe në fillim të vitit 2023 u vu re një rënie e frikshme e këtyre interesave. Ndryshime të tilla të normave të interesit frikësojnë tregun e investimeve dhe vetë fondet e investimit. Kështu që ne ende po studiojmë tregun dhe po monitorojmë ankandet e letrave me vlerë të qeverisë shqiptare.

Ne shpresojmë që normat e interesit të stabilizohen, të mos ketë ndryshime kaq të mëdha nga ankandi në ankand. Kjo do të çojë në stabilitet të tregut të investimeve.

Ngjarjet kryesore nga UNIQA Insurance Group



“Jetojmë ‘green’ së bashku”/ UNIQA, kompania e parë e sigurimeve në Austri me objektiva ambicioze për të reduktuar emetimet

Sigurimi luan një rol kyç në zbutjen e ngrohjes së mëtejshme globale dhe arritjen e qëllimeve të Marrëveshjes së Parisit. Sektori menaxhon rreth 11 trilionë euro vetëm në Evropë.

Dhe transformimi “green” i ekonomisë evropiane mund të ketë sukses vetëm nëse këto para investohen në kompani që operojnë në mënyrë të qëndrueshme.

“Ne jemi të vetëdijshëm për përgjegjësinë tonë dhe i kemi vendosur vetes objektiva ambicioze: emetimet neto zero deri në vitin 2040 në Austri dhe deri në vitin 2050 në të gjitha vendet e Grupit UNIQA. Prandaj, portofoli ynë i investimeve është në përputhje të vazhdueshme me objektivin e Marrëveshjes së Parisit 1.5°C”, shpjegoi René Knapp, Anëtar i Bordit Drejtues dhe Drejtues për Markën

dhe Qëndrueshmërinë në UNIQA Insurance Group AG.

UNIQA bëhet kështu e vetmja kompani austriake e sigurimeve, objektivat e përkohshëm të së cilës janë vërtetuar me sukses. Aktualisht nuk ka asnjë kompani tjetër në të gjithë sektorin financiar austriak, objektivat e përkohshëm 1.5°C të së cilës janë njohur nga SBTi. Këto objektiva të bazuara në shkencë bazohen në një parim të thjeshtë: fokusimi në sasinë e emetimeve që duhet të reduktohen për të arritur qëllimin kryesor të Marrëveshjes së Parisit për të kufizuar ngrohjen globale në 1.5°C.

“Ne po veprojmë në përputhje me gjetjet dhe parimet shkencore për të reduktuar emetimet tona të gazeve serrë. Ne jemi krenarë që objektivat e reduktimit të bazuar në shkencë të UNIQA janë verifikuar dhe konfirmuar nga SBTi”, thotë Knapp, i cili shton se, kjo sjellje forcon besueshmërinë e publikut të grupit.

“Sektori financiar është kyç për reduktimin e emetimeve. Ne e përgëzojmë UNIQA Insurance Group për vendosjen e objektivave të bazuara në shkencë që mbulojnë jo vetëm emetimet e tyre operacionale, por edhe portofolin e tyre të investimeve”, tha Luiz Amaral, Drejtor Ekzekutiv i nismës së Objektivave të Bazuar në Shkencë.

“Objektivat e UNIQA Insurance Group vijnë në një moment kyç për sektorin dhe demonstrojnë veprimet urgjente të nevojshme për të parandaluar efektet më të dëmshme të ndryshimeve klimatike”.

Detaje mbi objektivat e përkohshme të UNIQA:

Dalja nga përdorimi i qymyrit, naftës dhe gazit natyror

UNIQA ka një udhërrëfyes të qartë për largimin nga lëndët djegëse fosile si qymyri, nafta dhe gazi natyror. Kompania tashmë nuk po bën më asnjë investim të ri në qymyrose naftë, dhe nga viti 2024 asnjë biznes i ri nuk mund të merret në sigurim nëse përdor këto produkte.

Energjia e gjelbër në UNIQA

UNIQA po ndërmer veprimet e duhura në fushën e ekologjisë së biznesit. Vënia në punë e sistemit të ri fotovoltaik në çatinë e selisë së UNIQA në verën e vitit 2023, më i madhi ndonjëherë në një ndërtesë të një kompanie, është një moment historik i madh: falë fuqisë së tij prej 125 kWp, ai do të jetë në gjendje të prodhojë 100,000 kWh energji elektrike për vit në të ardhmen. Kjo korrespondon me konsumin vjetor të rreth 30 familjeve dhe do të shmangë emetimet e rreth 21 tonë CO2 në total.

UNIQA ka rritur prodhimin e saj fotovoltaik të instaluar nga 50 kWp në mbi 400 kWp që nga viti 2020, një rritje 8-fish në vetëm pak vite. Deri në vitin 2035, prodhimi fotovoltaik

duhet të jetë së paku 600 kWp.

UNIQA gjithashtu ka blerë 100% energji elektrike të gjelbër prej vitesh në Austri. Nga viti 2024 e në vazhdim do të blihet vetëm energji elektrike “green” e certifikuar me Eco-label Austriak 46 (UZ 46 “Green Electricity”).

“Për një të nesërme më të mirë për klientët tanë”/ UNIQA i bashkohet “Eurapco Alliance”

“UNIQA Insurance Group”, gjigandi austriak i sigurimeve, që pjesë të sajën ka edhe kompaninë shqiptare SIGAL UNIQA Group Austria, i është bashkuar “Aleancës Eurapco”.

E përbërë nga tetë kompani të pavarura evropiane të sigurimit, kjo aleancë siguron dhjetëra miliona evropianë dhe është aktive në të gjithë kontinentin.

Disa të dhëna mbi “Aleancën Eurapco”

- Primet e shkruara vjetore – 56.8 miliardë euro
- Punonjës – 62,989
- Klientët totalë të të gjithë partnerëve – 43,4 milionë
- Asetet nën menaxhim – 349,5 miliardë euro

Ky hap shkon paralelisht me programin tonë strategjik UNIQA 3.0, në të cilën kompania austriake është angazhuar prej disa vitesh tashmë.

“Së bashku, ne do të kontribuojmë për një të nesërme më të mirë, të suksesshme dhe të qëndrueshme për klientët tanë, punonjësit dhe industrinë tonë”, shprehet Wolfgang Kindl, Anëtar i Bordit të Menaxhimit për Klientët dhe Tregjet Ndërkombëtare në “UNIQA Insurance Group”.

UNIQA 3.0

Programi ynë për të ardhmen

Identiteti ynë

Premtimi ynë

Ne mbrojmë dhe përmirësojmë shëndetin dhe prosperitetin përmes komunitetit tonë të fortë. Të zgjedhësh UNIQA-n, do të thotë të zgjedhësh një jetë më të mirë.

Parimet tona

Klienti është i pari

Fokusi ynë janë nevojat e klientëve tanë.

Thjeshtësia

Veprojmë dhe mësojmë nga gabimet.

Përgjegjësi

Inkurajojmë njëri-tjetrin për të marrë përgjegjësi.

Integritet

Mbajmë premtimet tona.

Komunitet

Bashkëpunojmë përtej barrierave.

Strategjia jonë

1. Të bëjmë biznesin e sigurimeve më të fokusuar te klientët, më fitimprurës dhe të ofrojmë shërbime inovative.
2. Zhvillimi i segmenteve të reja të biznesit në sektorin e kujdesit shëndetësor.
3. Punonjësit tanë janë burimi më i rëndësishëm në UNIQA.

Qëllimet tona

- Lider në tregun austriak.
- Top 5 në fokusin e tregjeve ndërkombëtare.
- Ofruesi më i mirë i shërbimit.
- Punëdhënësi më tërheqës.
- Garantimi i efikasitetit dhe kostos përfituese.
- Të ndërtojmë modele të reja biznesi.

Iniciativat financiare

Iniciativat kryesore financiare		Iniciativat kryesore financiare			
		2020	2021	2022	2025
Rritje	Austri- lidhshin tregtar Europa Qendrore dhe Lindore- e 5 në treg Segmente të reja biznesi-SanusX				
	Rritja e Primeve	3.6%	14.2%	3.9%	ø 3% p. a.
Fitime	Reduktimi i kosove në Austri dhe EQL Rritje e rentabilitetit-pronë/ sigurimet nga fatkeqësitë Strabilitet i portofolit- Sigurimi i jetës				
	Raporti i kostos Raporti i kombinuar Kthimi nga kapitali	29.4% 97.8% 0.6%	27.4% 93.7% 9.3%	27.2% 92.9% 14.4%	~ 25% < 94% 8-10%
Kualitet	Pozicionim i fortë i aftësisë paguese Pagesë tërheqëse e dividendit Ofruesi më i mirë i shërbimit				
	Raporti i aftësisë paguese Klient i lumtur-Austri Klient i lumtur-EQL	170% 4.2 4.4	196% 3.9 4.6	246% 4.5 4.5	> 170% ≥ 4.5 ≥ 4.5

Vlerësime kombëtare dhe ndërkombëtare

SIGAL UNIQA, mes 'Top 50' kompanive më të mëdha të sigurimit në Evropën Juglindore



Kompania e sigurimeve "SIGAL UNIQA Group Austria", nuk është thjesht më e madhja dhe më e besuara në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

Kompania e themeluar në vitin 1999 dhe pjesë e "UNIQA Insurance Group" është edhe një ndër më të mëdhatë në Evropën Juglindore.

Sipas "Top SEE 100 Insurers", publikuar nga "See News", SIGAL UNIQA, e cila gjatë vitit 2021 rënditej në vendin e 51, është rritur me 3 pozicione për vitin 2022 duke hyrë në Top 50 (vendi 48).

Grupi "SIGAL UNIQA" ka shënuar rritje jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

SIGAL UNIQA Group Austria – Kosova ren-

ditet në vendin e 92-të nga vendi i 98-të (2021), ndërsa UNIQA në Maqedoninë e Veriut është në pozitën e 85-të, duke u përmirësuar me dy pozicione krahasuar me një vit më parë.

Sipas CEO-s së



Grupit, z.Avni Ponari, viti 2022, edhe pse i vështirë për shkak të luftës në Ukrainë dhe pasojave që vijnë të ndihen nga pandemia "COVID-19", ka qenë i suksesshëm për SIGAL UNIQA Group Austria-n.

"Viti 2022 nuk ka qenë shumë i lehtë. Pasojat e pandemisë botërore COVID-19 vijojnë ende të kenë ndikim, sulmi rus në Ukrainë ka pësuar ulje dhe ngritje të shpeshta, duke na e bërë jetën jo fort të sigurt. Por pavarësisht këtyre, 2022 ishte edhe një vit që na dha përparësi në udhëkryqe të reja, që na drejtojnë në rrugëtime të cilat nuk i kemi hasur më parë. Baza jonë solide dhe elastike e ka bërë 'SIGAL UNIQA Group Austria' lehtësisht të adaptueshëm në situata të panjohura dhe të thjeshtë për të reaguar shpejt në situata në ndryshim", shprehet ai.

"Top SEE 100 Insurers" është një renditje vjetore e kompanive më të mëdha në Evropën Juglindore, sipas të ardhurave totale për vitin 2022. Ajo mbulon kompanitë financiare të regjistruara në Shqipëri, Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Maqedoninë e Veriut, Moldavi, Mali i Zi, Rumani, Serbi dhe Slloveni.

CEO i "SIGAL UNIQA Group Austria" nderohet me çmimin "Grand Excellence 2023"

Bordi i "Albanian Excellence" ka nderuar me çmimin "Grand Excellence 2023" themeluesin dhe Drejtorin e Përgjithshëm të SIGAL UNIQA Group Austria, z.Avni Ponari.

Çmimi iu dorëzua z.Ponari gjatë një darke gala në Tiranë si një shenjë mirënjohje për të gjithë kontributin e vyer që ka dhënë gjatë gjithë aktivitetit të tij në krye të Grupit më të madh të

sigurimeve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

“Ju, si Drejtor i Përgjithshëm SIGAL UNIQA Group Austria që prej 22 shkurt 1999, keni bërë që ajo të jetë kompania lider dhe më e suksesshme e tregut të sigurimeve në Shqipëri dhe në Rajon.

Ju jeni një ndër sipërmarrësit më të suksesshëm në vend, duke u shndërruar jo vetëm në një lider në fushën e biznesit, por dhe me ndikim pozitiv në zhvillimet e jetës ekonomike, sociale, sportive dhe kulturore të vendit”, thuhet ndër të tjera në motivacionin e “Albanian Excellence”.

“The Best Of Kosovo 2023”/ SIGAL UNIQA shpallet sërish “Tatimpaguesi i Vitit”

“The Best Of Kosovo 2023”, një mbrëmje gala organizuar nga Oda Ekonomike e Kosovës dhe e kthyer në traditë të përvitshme tashmë, ndau çmimet për bizneset dhe sipërmarrjet më të suksesshme në vend.

“SIGAL UNIQA Group Austria”, kompania lider e sigurimeve në Kosovë u vlerësua edhe këtë edicion me çmimin “Tatimpaguesi i Vitit 2023”.



Ky vlerësim për SIGAL UNIQA Kosova vjen pak javë pasi kompania kremtoi 20-vjetorin e themelimit.

Në dy dekada të ekzistencës së saj në tregun e sigurimeve në Kosovë, kompania jo vetëm që ka fituar besimin e qytetarëve dhe bizneseve, jo vetëm që është paguesi më i madh i dëmeve por është pjesë integrale e shoqërisë me fokus të veçantë në sport, art, kulturë, edukim etj.

“Brendi më i mirë i sigurimeve 2022”, UNIQA Maqedoni vlerësohet me çmim nga faqja e

njohur ndërkombëtare

“UNIQA Maqedoni” vlerësohet nga faqja e njohur ndërkombëtare “Global Banking & Finance” me çmimin “Brendi më i mirë i sigurimeve në Maqedoninë e Veriut 2022”.

“Global Banking & Finance” bazohet në disa kriteret para se të akordojë çmimet, duke përfshirë besimin e klientit, cilësinë e shërbimit, inovacionin, përgjegjësinë sociale, avantazhin strategjik në raport me konkurrencën dhe vlerën e primit të shkruar.

“Ky çmim mbarëbotëror dhe titulli ndërkombëtar në botë është një nder i vërtetë për Kompaninë tonë të Sigurimeve dhe dëshmi e menaxhimit të mirë, modelit të shëndetshëm të biznesit, besimit të klientit dhe angazhimit të ekipit. I jam mirënjohës klientëve tanë dhe të gjithë kolegëve të mi. Pa ata nuk do të ishte i mundur asnjë çmim”, shprehet CEO i “UNIQA Macedonia”, Driton Azizi.

Ky çmim tregon edhe një herë se kompania e sigurimeve “UNIQA Maqedoni” zhvillon aktivitetin e saj në të njëjtat standarte me kompanitë e sigurimeve kudo në Europë.

Kompania e sigurimeve “UNIQA Macedonia”, pjesë e SIGAL UNIQA Group, prej 18 vitesh në tregun maqedonas të sigurimeve, ka shënuar suksese të jashtëzakonshme ndërsa ka ditur t’ju

shërbejë klientëve mirë, t’ju japë produktin e nevojshëm që ata duan.

Kompania ka qenë gjithmonë afër klientëve, jo vetëm kur marrin primin por veçanërisht kur ata kanë nevojë dhe kur duhet paguar dëmi.

Ajo ka ditur gjithashtu të jetë edhe pranë komunitetit me aktivitete të ndryshme ku ka marrë pjesë ose ka sponsorizuar.

“AssCompact Award 2023 / 3 çmime të rëndësishme për “UNIQA Insurance Group”

Kompania austriake e sigurimeve “UNIQA Insurance Group”, pjesë e së cilës është edhe SIGAL UNIQA, është fituese e tre çmimeve AssCompact.

Medalje ari në “Sigurimin e Aksidenteve” dhe dy medalje të argjendta në “Sigurime Shëndetësore” dhe “Shërbimi më i mirë për Partnerët”.

Vendi i parë në sigurimin e aksidenteve konfirmon ekspertizën e kësaj kompanie në këtë fushë.

“Ne kemi qenë lider në treg në fushën e sigurimit nga aksidentet për më shumë se një dekadë. Ne fokusohemi në nevojat e njerëzve dhe u ofrojmë atyre siguri individuale, të përshtatur me aktivitetet e tyre personale të kohës së lirë dhe preferencat sportive. Këtë e kemi zbatuar rreptësisht edhe me produktin tonë të ri të aksidenteve, të cilin e kemi prezantuar në fillim të kësaj vere. Klientët tanë paguajnë vetëm për atë që u nevojitet. Në kohën e rritjes së çmimeve, kjo është një veçori bindës e produktit. Kjo konfirmon kërkesën e jashtëzakonshme dhe tani edhe vendin e parë në AssCompact Awards”, thotë Peter Humer, Anëtar Bordi për Customer & Market Austria në “UNIQA Insurance Group”.

“Shumë faleminderit partnerëve tanë të shitjes për besimin që na kanë dhënë. Ne jemi shumë të lumtur për çmimet dhe në të njëjtën kohë i shohim si një nxitje të madhe për t’u përmirësuar vazhdimisht. Gjithashtu dëshiroj të shpreh falënderimet e mia të sinqerta për

të gjithë ekipin e UNIQA për bashkëpunimin e shkëlqyer – në përputhje me deklaratën e misionit tonë”, shprehet Christian Voith, Shef i “UNIQA Broker dhe Partner Sales”.

“Brandi më i mirë i punëdhënësit për vitin 2023 / Tjetër vlerësim për “UNIQA Insurance Group”

Në konferencën “Tërheqja e Talenteve për vitin 2023”, UNIQA ka fituar çmimin e bronzitë për “Brandin më të mirë të punëdhënësit për vitin 2023”.



Çmimi shkoi për fushatën tonë të parë të brandit të punëdhënësit #startyourbetter, e cila mund të shihet në të gjithë Austrinë në fund të vitit 2022.

Ky vlerësim tregon gjithashtu se përpjekjet e kompanisë po japin rezultat dhe se po bën hapa të mëdhenj drejt synimit afatgjatë për të qenë punëdhënësi më tërheqës në sektorin financiar.

Standardet më të larta të sigurisë së informacionit për klientët dhe partnerët SIGAL UNIQA certifikohet me “ISO 27001:2022

SIGAL UNIQA Group Austria, certifikohet nga “AXE Register”, një organ certifikimi i Akredituar dhe i njohur në mbarë botën, për përmbushjen e kërkesave të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit, sipas standardit ndërkombëtar ISO 27001:2022.

Kjo certifikatë dëshmon cilësi në implementimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sigurisë së informacionit në Grupin SIGAL UNIQA dhe vlen në fushat e veprimtarisë së kompanisë:

- Marrja në sigurim
- Marrja në risigurim
Ky certifikim nuk është vetëm një arritje teknike për kompaninë numër 1 të sigurimeve, por gjithashtu një shenjë e qartë e angazhimit të saj ndaj klientëve dhe partnerëve duke ju ofruar standardet më të larta të sigurisë së informacionit.

Me anë të këtij certifikimi SIGAL UNIQA arrin krijorë një ambient besues dhe të sigurtë biznesi duke transmetuar një imazh të lartë cilësie për shërbimet që ajo ofron.

Çfarë është ISO 27001:2022?

ISO 27001:2022 është standardi më i njohur në botë për sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit dhe u ofron kompanive të çdo madhësie, në të gjithë sektorët, udhëzime për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të menaxhimit të sigurisë së informacionit.

Pajtueshmëria me ISO 27001:2022 do të thotë që një biznes ka vendosur një sistem për të menaxhuar rreziqet që lidhen me sigurinë e të dhënave që zotërohen ose trajtohen nga ajo dhe se ky sistem respekton të gjitha praktikrat dhe parimet sipas Standardit Ndërkombëtar.

Pse është i rëndësishëm ISO 27001:2022?

Me krimin kibernetik në rritje, menaxhimi i këtyre kërcënimeve mund të duket e vështirë apo edhe e pamundur.

ISO 27001:2022 ndihmon organizatat të ndërgjegjësohen për rreziqet në mënyrën më proaktive dhe të identifikojnë dhe adresojnë pikat e dobëta.

Një sistem i menaxhimit të sigurisë së informacionit, i zbatuar sipas këtij standardi, është mjeti i duhur për menaxhimin e sigurisë kibernetike dhe përsosmërinë operacionale.



Avantazhet për kompanitë që certifikohen:
Forcon ndërfunksionalitetin e sigurisë së informacionit dhe shton besimin e klientëve dhe partnerëve Integron informacionin dhe sigurinë e sistemeve në strategjinë e përgjithshme të menaxhimit të rrezikut të kompanisë Plotëson kërkesat e palëve të interesuara (aksionarë, ligjvënës, klientë, personel, komunitet) duke garantuar qëndrueshmërinë e biznesit Redukton ndodhinë e ngjarjeve, që përfshijnë detyrime ligjore dhe kontraktuale Përmirëson marrëdhëniet me

Administratën Publike Siguron mbrojtjen e sekreteve tregtare të kompanisë.

“Standard & Poor’s” vlerëson me “A” UNIQA-n



Agjencia Ndërkombëtare e Vlerësimit me seli në New York, “Standard & Poor’s” vlerëson kompaninë e sigurimeve “UNIQA Insurance Group” për arritjet gjatë vitit 2022, pavarësisht kushteve të vështira të tregut dhe zhvlerësimit të bonove ruse dhe ukrainase.

Sipas S&P, gjigandi austriak i sigurimeve do të “ruajë dhe zgjerojë pozicionin e saj të fortë konkurrues në tregun e saj vendas dhe në tregjet e Evropës Qëndrore dhe Lindore”.

Kur bëhet fjalë për indekset kryesore të aksioneve, të gjithë sytë janë “Standard & Poor’s”, që konsiderohet si etaloni i performancës së përgjithshme të tregut të aksioneve dhe korporatave të mëdha.

Punonjësit e SIGAL UNIQA-s: Kompetentë dhe të motivuar



Ne kërkojmë shumë nga punonjësit tanë. Ata duhet të dëgjojnë gjithmonë klientët dhe partnerët e biznesit dhe tu ofrojnë atyre mbështetjen më të mirë të mundshme gjatë gjithë kohës. Përpiqemi që të krijojmë një ambient sa më atraktiv të mundshëm, sepse ne besojmë që punonjësit që ndjehen mirë në punë ofrojnë dhe shërbim cilësor më të mirë.

Të orientuar drejt vlerave dhe aftësive

Ne jemi një kompani me karakter. Kemi shumë pika të forta, por sigurisht që bëjmë edhe gabime. Këtë karakter e përcaktojmë nëpërmjet vlerave të UNIQA-s. Punonjësit përfaqësojnë ne dhe shpirtin tonë të punës dhe na udhëzojnë ne për veprimet tona: kemi përcaktuar katër kompetencat kryesore për të gjitha këto vlera, duke filluar nga fokusi tek klientët tek të qenurit i hapur me ta, duke e parë këtë si kërkesën bazë për të përmbushur me sukses përgjegjësitë tona të ndryshme. Kjo është edhe arsyeja se përse i kushtojmë vëmendje të veçantë këtyre

kompetencave kur marrim punonjës të rinj, përveç kësaj konsiderojmë në mënyrë të veçantë njohuritë e tyre teknike.

Me një proces të strukturuar qartë, ne sigurohemi që punonjësit e rinj të ndjehen në duar të sigurat tek UNIQA që në fillim dhe janë të aftë të kontribuojnë në suksesin e kompanisë sa më shpejt të jetë e mundur.

Të mirëarsimuar

Ne i ndihmojmë punonjësit në zhvillimin personal dhe profesional të tyre nëpërmjet një game të gjerë formimi arsimor.

Menaxherët dhe punonjësit punojnë së bashku si pjesë e vlerësimeve vjetore të punonjësve për të përcaktuar masat specifike të zhvillimit për rritjen e mëtejshme personale dhe profesionale në bazë të detyrave të tyre kryesore dhe objektivave të përcaktuara.

Kurset e trajnimit dhe zhvillimit të UNIQA

përbëhen nga module të shumta të mësimit elektronik, seminare dhe trajnime në vendin e punës.

Të ndryshëm

Si punëdhënë në 17 shtete, ne e vlerësojmë shumëllojshmërinë e skuadrës tonë si një element shumë të rëndësishëm të suksesit tonë. Ne kujdesemi që të kemi punonjës nga kombësi të ndryshme dhe grupmosha të ndryshme, si dhe mbajmë një balancë të gjinisë. Më shumë se gjysma e punonjësve në UNIQA Group janë femra.

E ndajmë suksesin së bashku

Angazhimi dhe performanca vlerësohen shumë në UNIQA dhe për këtë punonjësit vlerësohen me vazhdimisht me çmime. Ne kemi një sistem bonusesh për menaxherët bazuar në suksesin financiar të kompanisë dhe një bonus në bazë të performancës në fushën e menaxhimit të shitjeve, të cilët i konsiderojmë si komponentë të rëndësishëm në sistemet tona të ndryshme të shpërblimit.

Përveç kësaj, UNIQA ofron mbështetje në terma afatgjatë për punonjësit e saj, në formën e pensionit privat, përfitime në rastet e paftësisë profesionale dhe pensione për të mbijetuarit në raste fatkeqësish.

Të angazhuar dhe të shëndetshëm

Punonjës të lumtur dhe të shëndetshëm janë performues të motivuar. Kjo është arsyeja se përse ne fokusohemi direkt tek shëndeti dhe promovimi i iniciativave të tilla si pushime falas, ulje për massage etj.

Gjithashtu, punonjësit e UNIQA mund të



marrin mbështetje për zgjidhjen e problemeve të tyre private ose profesionale, ose mund të përdorin më shumë sporte dhe mundësi relaksi pa pagesë.

Përgjegjësia sociale është pjesë e kulturës së korporatës tonë, për këtë arsye ne i inkurajojmë punonjësit tanë që të angazhohen në aktivitete sociale. Çdo vit, punonjësit mund të zgjedhin një ditë sociale në bazë të së cilës ata angazhohen në kauza sociale.

Përgjegjësi Sociale

**Më shumë se
një kompani
sigurimi**

Klinika lëvizëse "SIGAL UNIQA VITAL TRUCK" në Elbasan dhe Tamarë

Me qëllim promovimin e shëndetit të mirë, kompania e sigurimeve SIGAL UNIQA Group Austria, nën idenë e gjigandit austriak "UNIQA Insurance Group", ndërtoi të parën dhe të vetmë klinikë lëvizëse në Shqipëri dhe rajon, e cila edhe sot gjendet në ato zona ku banorët kanë më shumë nevojë.



UNIQA Group Austria në Vlorë, Durrës dhe Lezhë organizuan aksionin e pastrimit të vijës bregdetare.

Për disa orë, stafi i SIGAL UNIQA bash-

koi forcat për pastrimin e plazheve për disa kilometra, duke grumbulluar shumë thasë me mbeturina.

Nën moton "Më mirë të parandalosh një sëmundje sesa ta kurosh atë", stacionet e rradhës të Klinikës Lëvizëse "SIGAL UNIQA Vital Truck" gjatë vitit 2023 ishin zona e Bradasheshit në Elbasan dhe fshati turistik i Tamarës në veri të vendit.

Nisma që ka ndërmarrë SIGAL UNIQA, me të gjitha degët e saj në qytetet bregdetare, ka për qëllim heqjen e mbeturinave nga plazhi dhe përmirësimin e përvojës të turistëve vendas dhe të huaj që i vizitojnë ato.

Qindra banorë të dy zonave të sipërcituara përfituan nga kjo mundësi e artë e ofruar nga kompania më e madhe e sigurimeve, SIGAL UNIQA Group Austria, për tu konsultuar me mjekë specialistë dhe për të kryer ekzaminimet, cilat tregojnë parametrat më të rëndësishme shëndetësore.

Në politikat e saj, SIGAL UNIQA ka mbështetur përherë nismat në dobi të ambientit. Për kompaninë më të madhe të sigurimeve në Shqipëri është shumë i rëndësishëm raporti harmonik midis veprimtarisë së përditshme dhe kujdesjes ndaj ambientit.

Banorët e zonave u shprehën falenderues ndaj SIGAL UNIQA-s dhe drejtuesit të saj z. Avni Ponari duke u shprehur më tej se zona të tilla, larg qendrave urbane, kanë më shumë nevojë për prezencë të bluzave të bardha.

Për këtë arsye prej disa vitesh kompania, pjesë e "UNIQA Insurance Group", ofron edhe mundësinë e blerjes online të çdo sig-

Së bashku në mbrojtje të mjedisit/ Punonjësit e SIGAL UNIQA aksion pastrimi në plazhet e vendit

Teksa Shqipëria po shndërrohet në një atraksion turistik të preferuar për shumë shtete, punonjësit e SIGAL



uracioni në mënyrë që të reduktohet sa më shumë përdorimi i letrës dhe ndikimi në mjedis të jetë sa më minimal.

Mbrëmja Gala e Bamirësisë/ Orkestra "SIGAL UNIQA" ngroh shpirtrat e të pranishmëve me tingujt mahnitës të Vivaldit



Në Ditën Botërore të Vullnetarizmit dhe në 102-vjetorin e themelimit të Kryqit të Kuq Shqiptar u zhvillua mbrëmjen e sotme në Tiranë "Mbrëmja Gala e Bamirësisë".

Përveç interpretimit magjik të aktores Roza Anagnosti dhe zërit të fuqishëm të Marse-la Çibukaj, mbrëmjes nuk i mungoi as performanca e Orkestrës së Harqeve "SIGAL UNIQA", e cila ngrohu shpirtrat e të pranishmëve me tingujt mahnitës të kompozitorit të madh Vivaldi.

Kompania më e madhe dhe më e besur e sigurimeve në vend dhe rajon, SIGAL UNIQA Group Austria, i ka dhënë një rëndësi të veçantë edhe përgjegjësisë sociale teksa ka qenë mbështetëse e shumë aktiviteteve, në fusha të ndryshme.

Pikërisht në kuadër të Përgjegjësisë Sociale ndaj Komunitetit dhe nën moton "jetojmë më mirë së bashku", SIGAL UNIQA Group Austria, në vitin 2009 ngriti Klubin e Artit dhe Kulturës.

Në këtë klub janë zhvilluar dhjetëra aktivitete kulturore ndër të cilat ekspozita pikture, mbrëmje muzikore, portrete artistësh, promovime librash dhe seminare me tematika të ndryshme.

Duke besuar se arti në përgjithësi dhe muzika në veçanti lumturon njerëzit duke shtuar shpresën tek ta, prej vitit 2013, pjesë e Klubit të Artit është Orkestra e Harqeve "SIGAL UNIQA", e përbërë nga 15 instrumentistë profesionistë dhe dirigjent Mjeshttrin e Madh Ermir Dizdari.

Mbrëmje muzikore në Rahovec, vlerësohet Orkestra "SIGAL UNIQA"

Orkestra e Harqeve "SIGAL UNIQA", e themeluar në vitin 2013 si ide dhe iniciativë e Drejtorit të Përgjithshëm të SIGAL UNIQA Group Austria, z. Avni Ponari, vijon të jetë pranë artdashësve përmes koncerteve të saj.

E përbërë nga 15 instrumentistë dhe e drejtuar nga dirigjenti Ermir Dizdari (Mjeshtër i Madh).



Orkestra e Harqeve, që mban emrin e kompanisë më të madhe të sigurimeve në rajon, ishte këtë të shtunë në Krushë të Madhe të Rahovecit, në Kosovë, për të dhënë shfaqjen e saj të rradhës.

Mes qindra të pranishmëve, Orkestra e Harqeve "SIGAL UNIQA" luajti një sërë pjesësh me motive patriotike ndërsa e gjitha loja e sa u shoqërua me duartrokitje të shumta.

Ndërkohë nuk mungoi vlerësimi i rradhës për kompaninë "SIGAL UNIQA Group Austria" nga autoritetet vendore.

Panairi i 26-të i Librit/ Eventit mbarëkombëtar të kulturës i ribashkohet edhe "Audio-books.al"

Në mjediset e Pallatit të Kongreseve në Ti-



ranë, nga data 15-19 nëntor 2023, u zhvillua Panairi i 26 i Librit, ngjarje mbarëkombëtare e kulturës që pritet me shumë interes.



Panairi i përvitshëm i librit mbledhi bashkë shtëpitë botuese nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, shkrimtarë, poetë, përkthyes dhe lexues, ku njihen me botimet e reja, diskutojnë mbi problematikat e letërsisë bashkëkohore, përkthimit në gjuhën shqipe dhe shumë aktivitetet të tjera me të autorë dhe studiues.

Këtë edicion, panairit iu ribashkua edhe e vetmja "Librari Digjitale" në Shqipëri, "SIGAL Audiobooks".

Platforma e parë dixhitale e librave audio në shqip, e cila sjell te shqiptarët brenda dhe jashtë kufijve pa asnjë kosto, librat e autorëve më të njohur vendas dhe të huaj, do të jetë për 5 ditë rresht me stendën e saj në panair ku çdo vizitor do të ketë mundësinë të njihet nga afër se çfarë është kjo platformë, çfarë ofron, si mund të përdoret dhe të testojnë live aplikacionin.

Aktualisht në "SIGAL Audiobooks.al" gjenden mbi 300 libra dhe informacione mbi sigurimet, të gjitha të disponueshme dhe të aksesueshme online për të gjithë.

Ndërsa janë mbi 50 mijë përdorues, të cilët në çdo moment mund të dëgjojnë falas, nga celulari ose kompjuteri, titujt që dëshirojnë.

Në "Aubiobooks.al" e gjejnë veten duke filluar që nga fëmijët e moshave të vogla, duke dëgjuar përrallat e tyre të preferuara, fëmijët pak më të rritur me librat shkollore apo libra artistike që u përshtaten moshës së tyre dhe deri tek të rriturit, që mund të dëgjojnë romane, histori, kulturë, e plot libra interesante dhe me vlera të mëdha.

Librat vijnë tek përdoruesit nëpërmjet zërave të njohur të personazheve që kanë shumë vite eksperiencë në gazetari dhe jetën publike, dhe me profesionalizmin dhe zërin e tyre unik përcjellin tek çdo dëgjues librat më të mirë të epokës moderne, si dhe të historisë e kulturës së vjetër mesjetare e të Rilindjes.

Mjafton të shkarkoni aplikacionin në App Store ose Play Store për të dëgjuar kudo dhe kurdo librat që dëshironi.

Regjistrimi është shumë i thjeshtë. Shkoni te pjesa "Login" dhe me vetëm një adresë e-maili mund të jeni një prej mijëra përdoruesve.

"UNIQA" në Maqedoninë e Veriut vijon traditën e dhurimit të gjakut

UNIQA Shkup, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq dhe Institutin e Mjekësisë së Transfuzionit në ambientet e Shoqërsisë organizuan një fushatë për dhurimin e gjakut në të cilën stafi i kompanisë tregoi edhe një herë anën humane si një kollektiv me një ndërgjegjësim të lartë të solidariteti duke dhuruar pika gjaku të cilat për dikë do të thonë jetë.



Nën moton "Të dhurosh gjak do të thotë të japësh shpresë, të shpëtosh jetë", stafi i kompanisë dhuroi gjak për ti ardhur në ndihmë çdokujt që ka nevojë për të.

SIGAL UNIQA mbështet Sportin Sponsorizimi i Kombëtares/ Ponari: Detyrim moral ndaj 1.2 milionë klientëve në 3 shtete



Avni Ponari, Drejtor i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Group Austria, në një intervistë për revistën "Monitor", shprehet se, të qënurit sponsor i Kombëtares është një reklamë e mirë për kompaninë. Megjithatë, sipas tij, kostot e sponsorizimit janë më të larta se kthimi që merr kompania.

Deri tani, sipas z.Ponari, SIGAL UNIQA, sponsorizimet në sport i ka ndërmarrë në kuadër të përgjegjësisë sociale, më shumë sesa të kthimit që një investim i tillë mund të sjellë.

Gjatë intervistës ai përsërit edhe një herë apelin për një ligj të veçantë për sponsorizimet në sport, i cili fatkeqësisht ende mungon në Shqipëri dhe do nxiste bizneset të investonin.

"Mungesa e një ligji për sponsorizimet, që vazhdoj ta them, krijon vështirësi", shprehet CEO i "SIGAL UNIQA Group Austria".

MONITOR: SIGAL UNIQA është një nga sponsorët e Kombëtares shqiptare të futbollit. Si e vlerësoni impaktin e fushatës pozitive të eliminatorëve dhe kualifikimit në European në rritjen e atraktivitetit të



Kombëtares nga pikëpamja komerciale?

Avni Ponari: Që prej themelimit të saj, në shkurtin e vitit 1999, SIGAL UNIQA ka qenë gjithmonë një mbështetëse e fortë, jo vetëm e Kombëtares së Futbollit, por në shumë disiplina sportive: në basketboll, atletikë etj. Sot, ne jemi sponsor gjeneral të ekipeve të njohura në Shqipëri dhe Kosovë.

SIGAL UNIQA është sponsor gjeneral i klubit më të vjetër të futbollit në Shqipëri, Vllaznia e Shkodrës dhe e ekipit më të titulluar në basketbollin e Kosovës dhe jo vetëm, SIGAL Prishtina.

Sigurisht që, të mbështetësh djemtë e Kombëtares Kuqezi është një tjetër ndjesi pasi ata janë krenaria jonë kombëtare dhe ambasadorët tanë më të mirë nëpër botë.

Që prej vitit 2016, SIGAL UNIQA Group Austria vijon të ketë nën mbrojtje, duke siguruar rreth 500 lojtarë të të gjithë Federatës Shqiptare të Futbollit si dhe stafin drejtues të Federatës.

Nëse flasim për kualifikimin për në fazën finale të Europeanit "Gjermani 2024", përveç se gëzimit dhe emocioneve që na dhuroi, rrit përgjegjësinë tek kompania, pasi përveç kujdesit ndaj futbollistëve dhe stafit drejtues, duhet të mendojmë edhe për mijëra tifozë që do të shkojnë në Gjermani. Ndaj jemi duke përgatitur një sërë paketash Sigurimi që, udhëtimi dhe qëndrimi atje të jenë një eksperiencë e paharrueshme, por mbi të gjitha e sigurtë.

Sa i përket anës komerciale, sigurisht që të kesh emrin dhe logon në fanellat e Kombëtares dhe në stadium, është një reklamë e mirë për kompaninë.



MONITOR: Çfarë avantazhesh ofron për një biznes të qenit sponsor i Kombëtares së futbollit dhe a besoni se rezultatet e mira sportive përkthehen edhe në përfitime për imazhin/brandin e sponsorëve?

Avni Ponari: Kombëtarja e Futbollit është vendi ky bashkohen të gjithë shqiptarët, brenda dhe jashtë Shqipërisë dhe ekspozimi i brandit në evente të tilla sigurisht që përkthehet në një marketing të mirë për SIGAL UNIQA-n.

Shpeshherë, gjatë ndeshjeve të Kombëtares në stadium, teksa shfaqej në fushë reklama e SIGAL UNIQA, kam dëgjuar shumë njerëz teksa thonë “SIGAL-i, ku kam siguruar makinën”, apo “Ja kompania e sigurimit ku kam sigurimin e shëndetit apo të shtëpisë”. Pra, mbetet një reklamë e mirë. Por më lejoni të ndalem në dy aspekte të rëndësishme:

E para, investimet e SIGAL UNIQA në sport por edhe në fusha të tjera, si arti, kultura etj, vijnë në kuadër të përgjegjësisë sociale. Si kompania më e madhe e sigurimeve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, e ndjejmë si detyrim moral karshi mbi 1.2 milion klientëve tanë që të jemi aktivë në jetën sociale të tre vendeve ku operojmë.

E dyta, mos harrojmë se, kostot e sponsorizimit janë gjithmonë më të larta se feedback-u që merr kompania.

Ndaj, unë vazhdimisht kam kërkuar një ligj të veçantë për Sponsorizimet në Sport, i cili fatkeqësisht ende mungon në Shqipëri dhe do nxiste bizneset të investonin në sport duke e bërë këtë të fundit më atraktiv dhe më të suksesshëm. Por deri tani insentivat kanë munguar, pavarësisht apelit të fortë që kemi bërë.



SIGAL UNIQA, sponsor gjeneral i Vllaznisë/ Ponari: Realizova një ëndërr

Unë gjithmonë ëndërroj që të jetë kampion. Kështu që uroj, që si SIGAL është kampion ashtu të jetë edhe Vllaznia. Sepse unë jam mësuar të bashkëpunoj vetëm me kampionë”.

Kështu u shpreh Avni Ponari, CEO i SIGAL UNIQA Group Austria, teksa bëri prezantimin zyrtar të kompanisë që ka themeluar dhe drejton si sponsor general të Klubit të Futbollit Vllaznia për sezonin futbollistik 2023-2024.

Kompania më e madhe e sigurimeve në



Shqipëri, e themeluar në vitin 1999 dhe me aktivitet edhe në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, do të jetë sponsor zyrtar i klubit më të vjetër të futbollit në vend.

Zyrtarizimi i marrëveshjes së bashkëpunimit u bë në një ceremoni të zhvilluar në ambjentet e stadiumit "Loro Boriçi" ku morën pjesë zyrtarë të klubit, drejtues të institucioneve lokale, ish futbollistë të Vllaznisë dhe tifozë të shumtë.

40 TROFE/ SIGAL PRISHTINA, SHTËPIA E KAMPIONËVE

I lumtur dhe shumë krenar që SIGAL Prishtina arriti edhe një herë të shkruajë historinë e basketbollit, jo vetëm në Kosovë por edhe në kontinent.

Suksesi në Qipro, ndaj Ael Limassol, i dha klubit prishtinas titullin e tretë të Ligës Ballkanike, një sukses i rëndësishëm për të cilin duhen falenderuar lojtarët dhe drejtuesit.

SIGAL UNIQA Group Austria dhe SIGAL Prishtina kanë 20 mbi vite që ecin së bashku dhe e them me shumë krenari që klubi ka ditur të përfaqësojë denjësisht kompaninë teksa sot numëron plot 40 trofe, kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

SIGAL UNIQA ka qenë gjithmonë një ogur i mirë për sportin dhe sportistët.

Luiza Gega e ka nisur aktivitetin e saj me logon e SIGAL UNIQA-s. Edhe Izmir Ismajlaj e ka nisur aktivitetin e tij po me logon e SIGAL UNIQA-s.

Me sponsor gjeneral SIGAL UNIQA-n, Valbona ishte ekip që e udhëhoqi për 5 vite rresht basketbollin në Shqipëri. Ndërsa sot vijojmë të jemi sponsorë të kombëtareve të futbollit dhe të basketbollit në Shqipëri dhe Kosovë, të klubit të Vllaznisë dhe mbësht-



esim një seri aktiviteteve sportive siç është edhe LIGA UNIKE në basketboll.

Sepse, SIGAL UNIQA është mësuar të bashkëpunoj vetëm me kampionë!

Ne besojmë fort se Sporti është mjeti më efikas i edukimit, i argëtimit, i parandalimit të sëmundjeve, dhe forcimit të marrëdhënieve sociale.

Prandaj, duke uruar edhe një herë SIGAL Prishtinën për suksesin e arritur, apeloj për më shumë vëmendje ndaj sportit, kryesisht në Shqipëri, si ambasadori dhe reklama më e mirë e një kombi.

Media

'Tetori Rozë' dhe ofertat novatore të SIGAL UNIQA/ Ponari në "Wake UP": Mbështetje financiare që secili të diagnostikohet dhe kurojë kancerin

gjejë formën për ta diagnostikuar dhe kuroar sëmundjen. Parimi ynë është më mirë ta parandalosh një sëmundje sesa ta kurosh atë", u shpreh ai.



Gjatë tetorit, muajit të sensibilizimit kundër kancerit të gjirit, CEO i SIGAL UNIQA Group Austria, z. Avni Ponari ishte i ftuar në emisionin "Wake UP", në Top Channel dhe Top Albania për të folur mbi produktet e sigurimit të shëndetit që ofron kompania më e madhe e sigurimeve në vend dhe çfarë i mundësojnë ato qytetarëve.

Z.Ponari përmendi fillimisht disa fakte mbi shtimin e rasteve me sëmundje kancerogjene jo vetëm në Shqipëri porë dhe në Evropë dhe botë.

"Sot, studimet e kompanive më të mëdha të sigurimeve dhe risigurimeve në botë, Swiss Re, Munich Re, Allianz etj, konstatojnë se kanceri është një sëmundje e rrezikshme dhe e përbotshme. Sipas statistikave, në disa vende të Evropës shkon 1 me 2 ose në vende të tjera 1 me 3 ose 1 me 4. Pra, 1 në 2, 3 apo 4 persona është i prekur nga kanceri.

Kjo do të thotë se ky rrezik është evident dhe duke qenë i tillë duhet të jemi të kujdesshëm. SIGAL UNIQA është pjesë e një grupi të madh financiar dhe ne jemi mbështetje financiare dhe krijojmë mundësitë që secili të

Sipas z.Ponari, kompania që ai drejton ofron produkte sigurimi shëndetësor dhe jo vetëm, inovatore dhe që të përballueshme për çdo shtresë të shoqërisë.

"Kemi dy produkte që janë të veçanta dhe të përbotshme. "Anti-Tumor", që është një paketë e cila në rast dignosti-

kimi të sëmundjes dhe me opinionin e dytë mjekësor, që ne marrim në Europë, përcaktojmë qartë tipin e sëmundjes.

Nëse sëmundja konstatohet, paketa përfshin çdo person, nga mosha 1 vjeç deri në 100 vjeç. Ndërsa "Jetë Plus" është një paketë ndryshe. Klienti gjen vetë spitalin kudo, në spitalet më të mira onkologjike të Europës. Këto sëmundje kanë nevojë të kesh besim te vetja, të kesh besim te ai që të shëron dhe me kostot e kurimit që mbulohen nga kompania e sigurimit.

Nuk duhet ta marrim kancerin si një sëmundje që po të zuri nuk shpëton. Në rast se mjekohesh mirë, në kohë dhe në klinikat e duhura 90% e rasteve janë të shërueshme", deklaroi ai.

Dhe zakonisht kostot financiare janë një problem...

"Ky është problemi themelor sepse nuk mund të shkosh në klinika dhe spitale të specializuara dhe që kanë kosto të larta sepse shërbimi aty është i lartë. Dhe nëse ti shkon me një fatura të garantuara atëherë je më i

qetë.

Shqiptarët shpenzojnë rreth 300 milionë euro çdo vit në klinika dhe spitale jashtë vendit. Është një shifër marramëndëse dhe nëse do ishin të sigurar kjo shumë, nëse e përkthejmë në prim sigurimi, do të ishte rreth 15 milionë euro. Nëse do të ndodhte kjo, çfarë kursimi të madh do të kishim”.

Te SIGAL UNIQA kemi edhe një propozim tjetër, “Check Up sipas protokollit japonez”. Çfarë do të thotë kjo?

“Duke qenë Konsull Nderi i Japonisë në Shqipëri dhe duke bërë disa vizita atje, pasi në Japoninë dhe SHBA i kishim përjashtuar sepse mendonim se ishte shumë e shtrenjtë. Por është totalisht e kundërta. Nëse një check up në Austri kushton 800 e ca euro, në Japoni kushton 400. Gjysmë për gjysmë.

Ne kur marrim analizat marrim një rezultat në një fletë ku thotë “ky rezultat kaq duhet të ishte kaq” por nuk shpjegon se çfarë është. Cila është problematika e stomakut, e mëlçisë, e veshkës etj. Një doktor i jashtëzakonshëm për çdo person.

Ne e pamë, e diskutuam, madje edhe me ambasadorin e Japonisë në Shqipëri. Sollëm një grup mjekësh që ta shpjegonin me detaje. Me një pikë gjak ti bën analizat e plota, për gjithçka”.

Ju keni edhe një aplikacion, TeleShëndet?

“Teleshëndet është sot një risi botërore. Në fillim në SHBA ka dalë me një kosto 800 dollarë në vit, ndërsa SIGAL UNIQA e ofron për vetm 50 euro në vit.

Në momentin që ti flet dhe mjeku nuk është i fushës së duhur ai njofton mjekun tjetër

sepse kur këtë shërbim e ke një vit apo më shumë historiku ruhet dhe e ke vetëm ti dhe mjeku. Askush tjetër. Mjeku është me ty dhe je “face to face”. Mjeku të sheh dhe e sheh. Plus edhe benefite të tejtra”, tha ndër të tjera z. Ponari.

Sigurim i detyrueshëm nga katastrofat? Ponari: Shteti mund ta bëjë vetë përmes dy formave



Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Group Austria, Avni Ponari ishte i ftuari i gazetares Oljana Maloku në “Pro Business”, në Klan Plus ku foli mbi mënyrën e menaxhimit të katastrofave natyrore, rolin e shtetit dhe ndikimin që duhet të ketë industria e sigurimeve.

immin që duhet të ketë industria e sigurimeve.

Nxitur nga tërmeti tragjik në Turqi, Z. Ponari u pyet nëse “duhet të kemi një skemë të detyrueshme të sigurimit nga katastrofat dhe se çfarë modeli duhet të ndjekim?”.

Sipas tij, modelet që duhen ndjekur ekzistojnë tashmë dhe se Shqipëria nuk ka nevojë të bëjë “shpikje” të reja

Avni Ponari: “Për mbrojtjen nga katastrofat ka disa zgjidhje. E para dhe më e preferueshmja do të ishte që qytetarët të siguroheshin vetë. Por për shkak të mentalitetit, shqiptarët në përgjithësi nuk e bëjnë diçka të tillë.

Njëra mënyrë është që këtë sigurim ta bëjë shteti, përmes dy formave.

E para, shteti vetë të blejë risk nga katastrofat në tregjet ndërkombëtare, deri në një limit të caktuar, duke paguar një prim të caktuar.

E dyta, të gjithë individët të marrin pjesë në skemë duke paguar prime dhe, nëse paguajnë të gjithë, atëherë primi do të rezultojë shumë i ulët, nga 1,500 deri në 5,000 lekë në vit për një banesë.

Në këtë mënyrë, tregu i sigurimeve mund të dalë në tregjet ndërkombëtare, të blejë një vlerë të caktuar risku nëpërmjet risigurimit.

Në rast dëmi, tregu i sigurimeve do të paguajë një pjesë të vogël të vlerës, ndërsa pjesën më të madhe i paguajnë risiguresit e huaj që i kanë risiguruar këto përgjegjësi.

Ekzistojnë modele dhe skema që mund të ndiqen dhe të implementohen, nuk është asgjë e re që duhet bërë për herë të parë. Duhet vetëm vullnet për vepruar..."

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA në Kosovë pagoi mbi 10 milionë euro dëme gjatë vitit 2023

Mbi 1.2 milionë qytetarë në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni e Veriut ia kanë besuar të ardhmen një kompanie sigurimesh ndër më të suksesshmet në Evropë me mbi 600 zyra.

Në Kosovë mbretëron një klimë shumë pozitive e të bërit biznes.

Fokusi kryesor është të ndihmojnë klientët të kenë një ndjenjë sigurie dhe të mbrohen në raste të papritura, thotë në një intervistë për KosovaPress, themeluesi dhe drejtori i përgjithshëm i SIGAL UNIQA, Avni Ponari.

Ponari thekson se kjo kompani ka paguar rreth 200 milionë euro dëme në Kosovë përgjatë këtyre 20 vjetëve.

Ai potencon se vetëm gjatë vitit 2023, vlera e dëmeve të paguara, kap shifrën rreth 10 milionë euro.

Drejtori i SIGAL UNIQA potencon se kjo kompani është e gatshme të marrë në sigurim objekte në miliarda euro, meqë sipas tij, natyra e punës dhe ndërtimit me partnerët ndërkombëtarë ndikon që të garantojnë një gjë të tillë.

Ai shton se numri i klientëve që kanë zgjedhur SIGAL UNIQA, arrin në mbi 1.5 milionë, për çka theksoi se fokus tjetër mbetet të jenë afër klientëve, përveç fizikisht edhe online.



"Për 20 vjet ne kemi paguar rreth 200 milionë dëme në Kosovë, ndërsa ky vit ka qenë rreth 10 milionë. Dëmet kanë qenë të niveleve të ndryshme, jo vetëm dëme motorike, por edhe shëndetësore, pasurore, sepse kjo është arsyeja pse ne jemi këtu... Prioriteti i një kompanie sigurimi, në përgjithësi, është i përcaktuar dhe fokusi është i ditur... Sot SIGAL është i gatshëm të marrë në sigurim objekte jo në miliona euro, por mbase edhe miliarda, sepse vetë natyra e punës dhe ndërtimit me partnerët ndërkombëtarë është e tillë që ne garantojmë dhe sigurojmë çdo lloj objekti dhe subjekti në territorin e Shqipërisë, duke përfshirë avionët, anijet, që i kemi në Shqipëri... 08:24 Sot, numri i klientëve në tri shtete është mbi 1.5 milionë banorë dhe i punonjësve është mbi 2 mijë e 200. Kemi një raport të drejtë dhe mbi 600-700 zyra në tri shtetet. Është një raport i drejtë i ndërtimit të përgjegjësive. Fokusi jonë tashmë është jo vetëm

të jemi afër klientit fizikisht, por edhe online”, thotë Ponari.

Punën mbi 20-vjeçare, Ponari e quan storie interesante, për çka thotë se përgjatë këtyre viteve kanë qenë lider në tregun e sigurimeve, duke e udhëhequr atë jo vetëm në pikëpamjen financiare, por edhe të produkteve në Kosovë, Shqipëri e Maqedoninë e Veriut.

Ai shton se SIGAL Group Austria është një nga 50 kompanitë më të mëdha të Evropës Qendrore dhe asaj Lindore, derisa shton se fokusi i tyre është që jenë gjithmonë afër klientëve.

Ponari potencon se po t’i kryente këto shërbime në vende të tjera me numër më të madh të popullsisë, kompania nuk do të ishte me shifrat aktuale, por do të korrte edhe më shumë suksese.

“20 vjet në Kosovë dhe mbi 25 në Shqipëri, është një histori interesante, nuk mund të themi suksesi, sepse kur themi sukses, do të thotë se ti vepron në një ambient me shumë klientë. Popullsia në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, ku ne operojmë, është e vogël - në tri shtetet, 6 apo 6.5 milionë banorë. Në qoftë se këtë punë që unë e kam bërë me stafin tim në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, do ta kisha bërë në një vend ku numri i popullsisë është i lartë dhe numri i konsumatorëve është i madh, natyrisht që kompania nuk do të ishte më në këto shifra që është sot, që totali i shifrës vjetore kalon 100 milionë euro dhe është në një nga 50 kompanitë më të mëdha të Evropës Qendrore dhe Lindore...Kjo periudhë ka qenë interesante, sepse ne kemi qenë lider në tregun e sigurimeve, e kemi udhëhequr këtë treg, jo vetëm në pikëpamjen financiare, por edhe në pikëpamjen e produkteve, duke qenë një shkollë e tregut të sigurimeve në të tri vendet. 05:36 Fokusi ynë ka qenë gjithmonë që të jemi afër punonjësve, por nga ana tjetër, të jemi edhe afër klientëve”, thotë Ponari për KosovaPress.

Përveç këtyre, drejtori i kësaj kompanie, Avni Ponari thotë se sigurimi përbën një nga tri

shtyllat e ekonomisë së një vendi.

Ai thekson se fatkeqësitë, sëmundjet, rreziqet natyrore, katastrofat janë rreziqe të cilat nuk shmangen, por zvogëlohen për shkak të sigurimeve.

Ponari potencon se sigurimet janë një industri që kanë vlera shumë të rëndësishme, për çka shton se janë edhe mbrojtëse të vlerave financiare.

“Sigurimet janë një industri që kanë vlera shumë të rëndësishme, sepse është njëra nga tri shtyllat e ekonomisë së një vendi. Fakti që kjo industri është mjaft e zhvilluar në botë, tregon që edhe fokusi i biznesit, njerëzve, qeverive të kjo industri, sepse në fund të fundit është mbrojtëse e vlerave financiare dhe e kthimit në pozicionet e mëparshme. Fatkeqësitë, sëmundjet, rreziqet natyrore, katastrofat janë rreziqe, të cilat nuk shmangen. Ato zvogëlohen me efektin e tyre, për shkak të sigurimeve. Sigurimet janë ato që i rikthejnë në pozicione financiare çdo lloj biznesi...

Sigurimet janë produkte që janë mjaft të lira dhe me një konsum sa më të vogël të duhanit apo të pijeve alkoolike, ti mund të zëvendësosh këtë lloj konsumi me një produkt sigurimi. Pra, do të sigurosh shtëpinë, shëndetin, një makinë kasko, bagëtitë në zonën ku je, fushën me grurë, mollë, rrush nga rreziqet natyrore, nga breshëri, shiu, stuhitë...Kjo e forcon personalitetin dhe dinjitetin e njeriut”, potencon Ponari.

Ponari: Jemi tregu më i varfër në botë sa i takon sigurimeve vullnetare

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka publikuar të dhënat për tregun e sigurimeve në vitin 2022, i cili ka pësuar rritje me 9%, krahasuar me një vit më parë.

Për, ish kryetarin e Shoqatës së Siguruesve, zotin Avni Ponari, tregu i sigurimeve nuk varret nga shifrat dhe përqindjet që tregojnë rritjen e një tregu.



Ponari në edicionin e lajmeve në MCN tv, u shpreh se ndryshimi në tregun e sigurimeve është kryesisht në sigurimet e detyrueshme dhe motorike, por jo në ato vullnetare.

Ajo që duhet theksuar dhe që është e rëndësishme për tregun e sigurime në Shqipëri dhe në të gjithë Evropën është që tregu i sigurimeve nuk varet nga shifrat apo përqindjet që tregojnë ngritjen apo uljen e një tregu.

E rëndësishme është sesa është kjo vlerë absolute ose më mirë të themi se sa është penetrimi dhe sa paguajnë për frymë qytetarët e një vendi në tregun e sigurimeve.

Aktualisht ajo pjesë që paguajnë qytetarët në tërësi nuk ka ndonjë ndryshim të madh dhe përqindjet nuk e reflektojnë këtë sepse ndryshimi ose penetrimi në tregun e sigurimeve është kryesisht në sigurimet e detyrueshme dhe motorike, që do të thotë sigurimi i detyrueshëm është sigurimi i automjeteve dhe të detyrueshme mbeten edhe ato sigurime vullnetare të cilat bëhen për shkak të asaj që bankat kërkojnë që ato që kanë kredi të sigurojnë pasuritë dhe jetën e tyre. Këto janë dy, tre treguesit themelor.

Ponari pohon se Shqipëria është e varur vetëm në sigurimet e detyrueshme teksa radhitemi si tregu më i varfër në botë sa i takon sigurime vullnetare.

Sipas tij vendet e rajonit paguajnë më shumë për frymë banori, krahasuar me Shqipërinë.

Pjesa tjetër që është e rëndësishme dhe që është sigurim vullnetar, pra që mbetet në dëshirën e klientëve është akoma në nivele shumë të ulëta.

Shqiptarët paguajnë 35-40€ për frymë në vit, që do të thotë se jemi tregu me i varfër, ndoshta edhe në botë dhe do të thotë se nuk jemi aty ku duhet dhe

ku kërkohet. Nëse do flisnim për shifra rritjeve atëherë do thonim se rritja është e tërësishme, nëse do thonin Maqedonia paguan rreth 15€ për frymë, Kosova rreth 120€ për frymë, Austria dhe komuniteti evropian mbi 3 mijë € për frymë, këto janë ndryshime të mëdha të cilat tregojnë se sa qytetarët që shqiptarë janë të ndërgjegjshëm dhe se sa janë të përgatitur për të hyre dhe për tu bërë pjesë e sigurimeve. Kështu që në këto shifra në përqindje japin një panoramë të përgjithshme që në fakt është sigurimi i detyrueshme dhe motorik dhe nuk japin realisht atë që është themelore, pra sigurimi i jetës penetrimi mbetet 2-3% në shkallë vendi, sigurimet vullnetare mbeten 3, 4, 5%, pra 97% mbetet e pasiguar ashtu siç është edhe jeta, ashtu siç është edhe shëndeti.

Pra këto shifra janë thjesht një paraqitje skematike por jo penetrim dhe ndryshim mentaliteti i shqiptarëve për tu afruar te tregu i sigurimeve.

“Kolonat private janë zgjidhja afatgjatë e problemit të pensioneve”

Elvis Ponari, Administrator i “SIGAL UNIQA Fond Pensioni”, thotë për “Monitor” se, që këto fonde të jenë të qëndrueshme, duhet që 20% e forcave aktive të punës të përfshihen në skemën private të pensioneve dhe që kjo skemë të jetë ndikuese, duhet të përfshihen

në të 50% e forcave aktive të punës.

Aktualisht, ky tregues në Shqipëri është 2.5%, ndërsa në Maqedoninë e Veriut ka arritur në afërsisht 70%.

Ai mendon se e vetmja zgjidhje afatgjatë për problemin e pensioneve në Shqipëri do të jetë ngritja e një kolone të dytë të pensione-ve private të detyrueshme dhe incentivimi sa më i madh i kolonës së tretë vullnetare.

Si e vlerësoni ecurinë e fondeve private të pensionit në vitin 2022 dhe cilat ishin zhvillimet kryesore në këtë segment të tregut?

Në Shqipëri ka 4 fonde pensioni, aktive në treg që prej vitit 2005. Dua ta theksoj, është një skemë sociale, që e ka krijuar shteti dhe e administron privatisht. Kemi dy banka dhe dy kompani sigurimi të fuqishme që kanë përgjegjësinë e miradministrit të aseteve të qytetarëve.

Tregu i pensioneve private po rritet me ritme të qëndrueshme në vitet e fundit. Edhe për vitin 2022 janë ruajtur po këto ritme, por përmasat e tij mbeten modeste, kur i krahasojmë edhe me vendet fqinjë.

Sipas të dhënave nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, vlera neto e aseteve të tregut të Pensioneve Vullnetare në fund të vitit 2022 arriti në rreth 5.7 miliardë lekë, ose rreth 49 milionë euro, me rritje 24.3% në krahasim me vitin 2021.

Sot që flasim, Maqedonia e Veriut ka 3 fonde pensioni privat, me 1.7 miliardë euro asete dhe 600.000 anëtarë.

Shteti e ka nxitur pensionin privat, pasi theksoj është skemë sociale, e ka plotësuar reformën e pensionit, duke i mundur qytetarit maqedonas që kur të dalë në pension, të marrë 3 pensione apo 3 paga dhe jo vetëm. Pra, të paktën të jetë te 60-80% e pagës para pensionit.

Numri i anëtarëve në Fondet e Pensioneve Vullnetare arriti në 36.518, ose rreth 8.8% më shumë se viti 2021. Në një vit punë kanë hyrë në skemë rreth 3.000 anëtarë apo klientë. 1.300 i ka sjellë vetëm SIGAL UNIQA FOND PENSIONI. Kjo shifër është e turpshme.

Shpresojmë se me projektligjin e ri, pra, me përmirësimin e ligjit në fuqi, do kemi më shumë lehtësi.



Kemi pasur numrin më të lartë të anëtarësimeve nga planet e pensioneve profesionale të subjekteve, që kanë rritje 14.2%. Biznesi e ka parë edhe më me interes pensionin privat, si një incentivë që t'i hapë një llogari punëmarrësit të tij. Pagën e ka për sot, pensionin e ka për mot.

Pjesëmarrja në Fondet e Pensioneve Vullnetare është 2.4% e forcave aktive të punës. Që këto fonde të jenë të qëndrueshme duhet që 20% e forcave aktive të punës të përfshihen në skemën private të pensioneve dhe që kjo skemë të jetë ndikuese, duhet që të përfshihen në të 50% e forcave aktive të punës, ose 350.000 kontribuues që paguajnë rregullisht.

Në Maqedoninë e Veriut është 70%. Për të arritur këtë, në vitin 2022 kemi punuar fuqishëm nëpërmjet marketingut, që çdo qytetar të njohë pensionet private dhe përparësitë që ka pjesëmarrja në këtë skemë. Krahas kësaj, kërkohet edhe një mbështetje nga shteti, sidomos në përmirësimin e legjislacionit aktual të pensioneve private.

Produkte dhe shërbime unike që përmirësojnë jetën

SIGAL UNIQA Group Austria, kompania më e madhe në tregun e sigurimeve shqiptare, ka ndërmarrë iniciativa të njëpasnjëshme, të bukura dhe inovative duke dashur të jetë jo vetëm afër klientëve, por mbi të gjitha në linjë me tendencat e reja të zhvillimeve teknologjike duke u mbështetur në avantazhet e saja më të forta për një menaxhim sa më të mirë të klientëve.

Sot, SIGAL UNIQA vjen pranë klientëve, brenda e jashtë vendit, me SIGAL ONLINE, platforma që ofron një mundësi fantastike për të aksesuar

Cfarë siguracioni ju nevojitet?

Blije Online në www.sigal.com.al direkt siguracionin që na nevojitet. Kushdo që do të blejë sigurimin e automjetit, shëndetit apo pronës ka mundësinë ta bëjë pa qenë nevoja të paraqitet në një zyrë të SIGAL UNIQA, vetëm me një klikim.

Hyni në <https://sigal.com.al/online/> dhe blini direkt nga celulari siguracionet që ju nevojiten. Shpejt, Thjesht dhe Sigurtë.

Gjithashtu, SIGAL UNIQA u ofron mundësinë që, nëse je i siguruar tashmë, të mund të informohesh në kohë rekord se si të veprosh në rast dëm.

Bli Online sigurimin që të nevojitet kudo ku ndodhesh

- ✓ Makinë
- ✓ Shtëpi
- ✓ Shëndet

sigal.com.al



Përballojmë sfidat së bashku

Sigurimi Antitumor nga SIGAL UNIQA

Merr
një ofertë
sigal.com.al

Sigurimi Anti Tumor

Nën moton “merr paratë dhe kujdesu për shëndetin”, SIGAL UNIQA Group Austria është e vetmja kompani në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, që ofron “Sigurimin Anti Tumor”, një siguracion dedikuar vetëm kancerit malinj dhe tumorit beninj në kokë. Ky sigurim ofron mbulim financiar të menjëhershëm në rast diagnostifi kimi me një prej këtyre dy sëmundjeve.

Shumën e siguruar e zgjedh vetë i siguruari. Duke filluar nga 5 mijë euro deri në vlera 50 mijë euro apo më shumë.

Meqënëse dëmshpërblimi akordohet në formë cash, në mënyrë të menjëhershme nga SIGAL UNIQA vetë i siguruari vendos se si do ta shpenzojë këtë shumë për trajtimin e tij mjekësor.

Qytetari duhet ti përgjigjet vetëm një pyetje, “nëse aktualisht ka kancer apo është diagnostikuar më parë me të”. Në rast se i përgjigjet “Jo” kësaj pyetjeje, atëherë kualifi kohet për t’u siguruar dhe nëse gjatë kohës që është i siguruar, diagnostikohet me këtë sëmundje me dy opinione të pavarura mjekësore që e konfirmojnë, atëherë të siguarit i akordohet shuma e siguruar CASH dhe menjëherë.

Përfitimet e siguracionit “Sigurimi Anti Tumor”:

- Mbulon tumorin malinj dhe tumorin beninj në kokë.
- Shuma e siguruar ofrohet menjëherë, cash, nëse diagnostikohesh me një nga dy sëmundjet e mësipërme.
- Mund të sigurohet çdo person nga 0-80 vjeç
- Mund të blihet në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut
- Mund të porositet edhe Online në www.sigal.com.al

Asistenca rrugore "AUTOSOS"








SIGAL UNIQA Group Austria mbetet e e para dhe e vetmja kompani sigurimi në Shqipëri që ofron për klientët e saj edhe shërbimin e Asistencës Rrugore "SIGAL UNIQA AutoSOS".

Ju le goma në rrugë, ju mbaron karburanti ose bateria apo përfshihen në një aksident në një vend të huaj ku askush nuk mund t'ju vijë në ndihmë, mos u shqetësoni! Me "SIGAL UNIQA AutoSOS" nuk do ta ndjeni kurrë veten vetëm.

Kohëzgjatje e shërbimit sipas nevojës Shërbimi i asistencës rrugore AutoSOS mundësohet për periudha 1 mujore ose 1-vjeçare në varësi të nevojave të klientit.

Ky shërbim blihet edhe Online në: <https://sigal.com.al/sigurimet-e-automjetit/autosos/>

Çfarë shërbimesh ofron "SIGAL UNIQA AutoSOS"?

-  Qendër Kontakti 24 orë të ditës në 7 ditë të javës
-  Shërbim karroatreci
-  Riparim në vend
-  Zëvendësim i automjetit në rast aksidenti
-  Parkim
-  Akomodimi në hotel
-  Riatdhesim ose vazhdim i udhëtimit drejt destinacionit

Bli Online
Shërbimin e Asistencës
Rrugore AutoSOS
në **sigal.com.al**
duke filluar nga
2000 Lekë



Çfarë përfshin protokollin japonez i analizave?



Mëso më shumë

"CHECK UP SIPAS PROTOKOLLIT JAPONEZ"

"CHECK UP sipas Protokollit Japonez" ofrohet tashmë edhe në Shqipëri, vetëm përmes SIGAL UNIQA Group Austria, e cila ju ofron mundësi pafund për të paraprirë në kohë sëmundjet që mund të jenë kërcënim serioz për jetën.

Si e ofron SIGAL UNIQA këtë mundësi unike?

Përmes aplikacionit "TeleShëndet", i vetmi i këtij lloji në Shqipëri, klientët e SIGAL UNIQA jo vetëm që mund të komunikojnë me mjekun 24 orë të ditës në 7 ditë të javës, të përfitojnë nga uljet dhe bonuset por edhe të kryejnë CHECK UP-in sipas "Protokollit Japonez" në spitalet dhe klinikat më të mira në Shqipëri.

Ky Check Up mund të blihet edhe Online në sigal.com.al

Të dhëna Financiare 2023

2023, një tjetër faqe suksesi / SIGAL UNIQA e mbyll vitin në krye të tregut të sigurimeve

Tregu i sigurimeve në Shqipëri u rrit me 8.9% gjatë vitit 2023.

Sipas të dhënave të publikuara nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, primet e shkruara bruto arritën një vlerë totale prej 22.9 miliardë lekë ose rreth 220 milionë euro.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës rreth 8%.

Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 38.94% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 61.06% të totalit të tregut.

Por cila është kompania më e madhe dhe më e besuar e sigurimeve në Shqipëri?

Të dhënat e AMF flasin qartë: Në Sigurimet e Jetës dhe të Jo-Jetës, në ato të detyrueshme dhe vullnetare, SIGAL UNIQA Group Austria mbetet kompania më e madhe dhe më e besuar e sigurimeve në Shqipëri.

Në Sigurimet e Jo-Jetës, 26%

Në Sigurimet e Jetës, 44,37%

Në Sigurimet e Pasurisë, 42,30%

Në Sigurimin Aksidente dhe Shëndeti, 47,81%

Në Sigurimin e Shëndetit Privat, 45,07%


Në Sigurimet Motorike, 21,14%

Në Sigurimet e Detyrueshme, 21,10%

Në Sigurimet Vullnetare, 36%

Nuk kishte si të ndodhte ndryshe teksa kompania shqiptaro-austriake ofron produktet më të mira të sigurimeve, është pranë klientëve kur ata kanë nevojë, res-

Ndarja e Tregut të Sigurimeve të Jo-Jetës Janar-Dhjetor 2023




pekton çdo kontratë konform ligjit, lidere në pagesat e drejtpërdrejta të dëmeve, ofertat e herëpashershme dhe mundësia që çdokush të sigurojë pronën, shëndetin apo automjetin pavarësisht të ardhurave që ka.

Nga 8 kompani që operojnë në tregun e sigurimeve të Jo-Jetës në Shqipëri, kompania që është pjesë e gjigandit austriak "UNIQA Insurance Group", mbetet në krye të tregut duke zotëruar 27,5% të tij. Shifër kjo konstante që prej themelimit të kompanisë në shkurt 1999.


Edhe sa i përket dëmeve të paguara, SIGAL UNIQA Group Austria ruan vendin e parë në treg teksa gjatë 2023-shit ka paguar tek klientët e saj rreth 15 milionë Euro dëmshpërblime.

Gjatë vitit të shkuar, sipas shifrave të AMF, SIGAL UNIQA Group Austria rezulton të ketë paguar mbi 23% të totalit të dëmeve që kanë paguar 12 kompanitë e sigurimit në Shqipëri.


Ndarja e Tregut të Sigurimet e Jetës Janar-Dhjetor 2023



Sigurimet Vullnetare



Ndarja e tregut të Fondit të Pensioneve për Asetet Neto



TREGU I PENSIONEVE PRIVATE "SIGAL UNIQA Fond Pensioni", më e madhja sa i përket aseteve

Tregu i fondeve të pensionit privat ka vijuar tendencën e tij në rritje, sa i përket vlerës së aktiveve neto dhe numrit të anëtarëve.

Në fund të vitit 2023, aktivet neto të këtij tregu arritën në 6.7 miliardë lekë, duke u rritur me 18.2%, ndërsa numri i anëtarëve arriti në mbi 38 mijë. Mbi 96% e aktiveve neto janë të investuara në obligacione të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë.

Gjatë vitit 2023, në tregun e fondeve të pensionit privat ushtruan aktivitetin e tyre gjashtë fonde pensioni të administruara nga katër shoqëri administruese, të cilat përveç administrimit të fondeve të pensionit janë licencuar për të administruar edhe sipërmarrje të investimeve kolektive.

Në treg aktualisht veprojnë gjashtë fonde të pensioneve private, të administruara nga katër shoqëri administruese.

Sipas numrit të anëtarëve, aktori më i madh në treg në fund të vitit 2023 Credins Pension, me rreth 49.38% të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, i ndjekur nga Sigal Pension me 29.45%, Albsig Pension me 10.68%, Raiffeisen Pension me 9.93%, Smart Pension, me 0.51% dhe Sigal Pro, me 0.06%.

Krahasuar me një vit më parë, fondi më i madh Credins Pension ka pësuar një rënie të lehtë në pjesën e tregut, ndërkohë që fondet e tjera kanë fituar terren, duke përfshirë edhe dy fondet që nisën aktivitetin në 2023, Smart pension dhe Sigal Pro.

Për nga vlera e aseteve neto, fondi më i madh është Sigal Pension me 41.29% të totalit, i ndjekur nga Credins Pension me 30.38%, Raiffeisen Pension me 20.73%, Albsig Pension me 7.33%, Smart Pension, me 0.26% dhe Sigal Pro, me 0.01%.

“Xprimm”: Tregu i sigurimeve në Kosovë shënon rritje gjatë 2023-shit. SIGAL UNIQA mbetet lidere në prime dhe dëmshpërblime

Primet e shkruara bruto të kompanive të sigurimeve në Kosovë u rritën me mbi 9% duke arritur në 146.5 milionë euro gjatë vitit 2023. Ndërsa totali i dëmeve të paguara bruto u rrit me 11.5% në vit duke arritur në 71.70 milionë euro.

Kështu shkruan “Xprimm” teksta i referohet shifrave zyrtare të publikuara nga Banka Qendrore e Kosovës.

Primet e shkruara bruto në sigurimet e jo-jetës arritën në 139.85 milionë euro, nga 127.72 milionë euro gjatë vitit 2022, ndërsa ato në sigurimin e jetës u rritën në 6,65 milionë euro nga 6,30 milionë euro.

Numri i policave të sigurimit të jo-jetës arriti në 1.48 milionë, nga të cilat 572.8 mijë TPL, 503 mijë polica kufitare dhe 405.7 mijë kontrata të tjera siguri.

Sipas të dhënave të publikuara nga Banka Qendrore, gjatë vitit 2023, fitimi neto i përgjithshëm i siguruesve vendas u trefishua duke arritur në 10.7 milionë euro nga 3.5 milionë euro gjatë 2022-shit.

Në të njëjtën kohë, asetet e kompanive të sigurimeve u rritën në 305.4 milionë euro, nga 267.5 milionë euro të një viti më parë. Nga këto, siguruesit e jetës mbajnë 25.5 milionë euro, ndërsa pjesa e mbetur prej 279.9 milionë euro administrohet nga siguruesit e jo-jetës.

Shifrat në fjalë përfshijnë të dhënat për 12 kompani të sigurimit që operojnë në Kosovë (7 prej tyre me pronësi të huaj), 10 sigurues të jo-jetës dhe dy të jetës.

Edhe për vitin 2023, sipas të dhënave

të sapopublikuara nga Banka Qendrore e Kosovës, SIGAL UNIQA Group Austria mbetet kompania më e madhe.


Sipas BQK, gjatë gjithë 2023 SIGAL UNIQA ka ruajtur pozitën e liderit në treg duke shënuar një volum primesh prej 19,046,899 eurosh.

Nga 10 kompanitë që operojnë në tregun e sigurimeve të jo-jetës, SIGAL UNIQA Kosovë zë 14% të tij.

Nëse e krahasojmë me vitin 2022, SIGAL UNIQA ka një rritje primesh prej mbi 2.5 milionë eurosh, çka tregon edhe besimin gjithmonë në rritje të qytetarëve dhe bizneseve ndaj kompanisë.

Edhe sa i përket dëmeve të paguara, SIGAL UNIQA Group Austria Kosovë mbetet sërish në krye të tregut.

Sipas të dhënave të BQK-së, SIGAL UNIQA ka paguar 16,3% të totalit të dëmeve të tregut gjatë vitit 2023. E thënë në shifra konkrete 11,465,739 Euro ose 3,6 milionë euro më shumë krahasuar me vitin 2022.



Gjatë vitit 2023, pronarët e automjeteve në Maqedoninë e Veriut shpenzuan 87 milionë euro për sigurimin e detyrueshëm të automjeteve.

Sipas Agjencisë së Mbikqyrjes së Sigurimeve, nga kjo shumë 21 milionë euro kanë shkuar vetëm për produktin "Kartoni Jeshil".

Gjatë vitit 2023, qytetarët, kompanitë dhe institucionet në Maqedoninë e Veriut kanë siguruar më shumë se 697.700 automjete. Numri total i sigurimit të detyrueshëm të automjeteve është rritur me 5% krahasuar me një vit më parë, raporton AMS.

Sipas të dhënave, 1 në 3 automjete të siguruar ka patur edhe Karton Jeshil, i detyrueshëm për udhëtimet jashtë vendit.

Gjatë vitit 2023, 11 kompanitë e sigurimeve kanë lëshuar 260,815 polica "Karton Jeshil", numri i të cilave është rritur me 20 mijë krahasuar me vitin 2022.

Primet e grumbulluar për këtë sigurim gjatë vitit 2023 arriti në 1,3 miliardë denarë ose 21,16 milionë euro)

Sa i përket sigurimit të detyrueshëm motoric, gjatë vitit të kaluar janë blerë gjithsej 958.528 polica ose 5,33 miliardë denarë (86,75 milionë euro).

Në Maqedoninë e Veriut, sigurimi i detyrueshëm TPL dhe Kartoni Jeshil kanë çmime të normativizuara të cilat i përcakton dhe i kontrollon Qeveria.

Sa i përket kompanive të sigurimit, "UNIQA" mban vendin e parë me 14,6%, ndërsa vijojnë "Makedonija Osiguruvanje" me 4,8%, "Kroacija Osiguruvanje – Jo-Jetë" me 9,9%, "Triglav Osiguruvanje" me 8,8% dhe "Sava Osiguruvanje" me 9%, "Viener VIG" zë 13,4%, "Eurolink" 8,4%, "Grave" 8,8%, "Halk Osiguruvanje" 6,4% dhe "Osiguritelna Polica" 9,5%.

2023, vit i suksesshëm për "UNIQA"-n: Primet u rritën me 10%, fitimet para taksave deri në 426 milionë euro

- Raporti i kombinuar është përmirësuar nga 91.7% në 89.4%
- Rritje e propozimit të dividendit prej 0.57 euro për aksion

Gjatë prezantimit të bilancit paraprak për vitin 2023, "UNIQA Insurance Group AG" njofton rritje të fortë të primeve dhe fitimeve.

Sipas kompanisë me seli në Vjenë, primet e shkruara u rritën me 9.7% duke arritur në 7,185.6 milionë euro, dhe fitimet para taksave ishin 426.4 milionë euro mbi pritjet.


"Vitin e kaluar 2023, kemi bërë pagesa të larta të dëmeve të lidhura me katastrofat natyrore, kryesisht për stuhitë e ndodhura në korrik dhe gusht.

Megjithatë, viti 2023 ishte një tjetër vit financiar i suksesshëm: ne ishim përsëri në gjendje të rriteshim ndjeshëm si grup dhe të rrisnim më tej fitimet tona. Kompanitë tona në EQL po zhvillohen në mënyrë të shkëlqyer dhe po japin një kontribut të konsiderueshëm në rritjen e përfitimit tonë", shprehet Andreas Brandstetter, CEO i "UNIQA Insurance Group".

Shifrat kryesore paraprake të Grupit për vitin 2023 në detaje:

"UNIQA Insurance Group AG" raporton në përputhje me standardet e reja të kontabilitetit SNRF 9 dhe SNRF 17, të cilat janë zbatuar që nga 1 janari 2023. Vlerat krahasuese për vitin 2022 jepen gjithashtu në përputhje me SNRF 9/17.

Një zhvillim pozitiv i qëndrueshëm mund të shihet në primet e shkruara nga "UNIQA Insurance Group AG", duke përfshirë pjesën e kursimeve të sigurimit të jetës të lidhur me njësinë dhe të lidhur me indeksin, i cili u rrit



në kompanitë ndërkombëtare me 15,3% në 2,429,9 milionë euro (2022: 2,107,7 milionë euro).

Rezultati i investimit u rrit në 588.8 milionë euro në vitin 2023 (2022: 179.8 milionë euro).

Fitimi para taksave i Grupit UNIQA u përmirësua në 426.4 milionë euro (2022: 421.7 milionë euro sipas SNRF 4*). Biznesi ndërkombëtar, në të cilin Rusia nuk përfshihet më, po jep një kontribut veçanërisht pozitiv në këtë.

Rezultati i konsoliduar (pjesa e rezulttit të periudhës që i atribuohet aksionerëve të UNIQA Insurance Group AG) u rrit me 18.3% në 302.7 milionë euro (2022: 256.0 mil-

ionë euro).

me 9.7% në 7,185.6 milion euro në 2023 (2022: 6,548.7 milion euro).

Qarkullimi i sigurimeve, të ardhurat nga nënshkrimi sipas SNRF 17, të Grupit u rrit me 12.1% në 5,994.1 milionë euro në vitin 2023 (2022: 5,346.9 milionë euro).

Këtu kontribuan të gjitha linjat dhe segmentet: sigurimi i pronës dhe viktimave u rrit me 12.9% në vitin 2023, sigurimi shëndetësor me 8.3% dhe sigurimi i jetës me 14.2%.

Në Austri, shitjet e sigurimeve u rritën me 8,6% duke arritur në 3,519,0 milionë euro në vitin 2023 (2022: 3,240,7 milionë euro),

ionë euro).

Kthimi nga kapitali (fitimet për periudhën nga operacionet e vazhdueshme në raport me kapitalin mesatar, duke përjashtuar pakicat) u rrit në 14.1 përqind në vitin raportues (2022: 11.6%). Kjo llogaritje nuk merr parasysh efektin e shitjes së planifikuar të kompanisë ruse (rezultat nga operacionet e ndërprera (pas taksave).

Raporti i kapitalit rregullator sipas Solvency II, i cili konsiderohet si tregues i kapitalizimit, ishte në një nivel të lartë në UNIQA më 31

dhjetor 2023, rreth 255% (2022: 246%).

Rezultatet në fushat e biznesit Sigurimi i pasurisë dhe viktimave

Primet e shkruara në sigurimin e pasurisë dhe viktimave u rritën me 14.4% në 4,214.3 milion euro në 2023 (2022: 3,683.0 milion euro). Faktorët vendimtarë ishin performanca e mirë e shitjeve dhe rregullimet e indeksit.

Kapitali i nënshkruar me lëvizjet e tij për kompaninë është në nivele stabil. Ndryshimet e tij vijnë kryesisht nga fitimet e realizuara në vite apo edhe rastet kur është vendosur shpërndarje fitimi në formën e dividendit. Ndryshimet në kapital për vitin 2023 janë sipas pasqyrës më poshtë:

<i>(Vlerat paraqitur ne 000 Leke)</i>				
	Kapitali aksionar	Rezerva të rrezikut të sigurimit	Fitimi i mbartur	Totali
Gjendja më 31 dhjetor 2021	2,232,909	260,496	1,592,390	4,085,796
Gjendja më 1 janar 2022	2,232,909	260,496	1,732,736	4,226,141
Fitimi i vitit	-	-	466,837	466,837
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	466,837	466,837
Transaksione me pronarët e Shoqërisë				
Dividendë të paguar	-	-	(260,000)	(260,000)
Totali i transaksioneve me pronarët e Shoqërisë	-	-	(260,000)	(260,000)
Gjendja më 31 dhjetor 2022	2,232,909	260,496	1,939,573	4,432,978
Gjendja më 1 janar 2023	2,232,909	260,496	1,939,573	4,432,978
Fitimi i vitit	-	-	333,711	333,711

Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	333,711	333,711
Transaksione me pronarët e Shoqërisë				
Dividendë të paguar	-	-	(300,000)	(300,000)
Totali i transaksioneve me pronarët e Shoqërisë	-	-	(300,000)	(300,000)
Gjendja më 31 dhjetor 2023	2,232,909	260,496	1,973,284	4,466,689

Kompania ka një gjendje monetare të qendrueshme, në rritje nga viti 2023. Mjetet e saj monetare janë në depozita bankare, të shpërndara thuajse në të gjitha bankat e nivelit të dytë me të cilat Kompania edhe bashkëpunon në fushën e sigurimeve. Për të paraqitur gjendjen e mjeteve monetare në llogaritë e saj bankare dhe në depozita në fund të vitit 2023 nga ana e jonë është përgatitur pasqyra më poshtë:

Mjete Monetare ne Arke dhe Banke (Ne 000 Leke)	Viti 2023
Mjete Monetare dhe ekuivalentë	127,495.59
Depozita me afat me bankat	5,239,158.28
Total	5,366,653.88

Gjendjet në llogaritë bankare dhe depozita sipas bankave të nivelit të dytë më të cilat Kompania Sigal Uniqa Group Austria punon, për vitin 2023 janë sipas pasqyrës më poshtë:

BANKAT (ne 000 Leke)	31 dhjetor 2023		31 dhjetor 2022	
	Mjete monetare dhe depozita me afat	Nga të cilat mjete monetare	Mjete monetare dhe depozita me afat	Nga të cilat mjete monetare
Banka Kombëtare Tregtare	1,791,796	25,414	2,426,551	17,273
Intesa San Paolo Bank	272,585	39,732	35,058	8,859
Raiffeisen Bank	44,569	12,314	45,562	9,165
Credins Bank	764,023	2,394	726,155	3,132
Banka Amerikane e Investimeve	413,910	17,858	762,070	4,125
OTP Bank	581,423	14,254	613,915	9,679
Veneto Banka				
National Bank of Greece – Albania				
International Commercial Bank				
ProCredit Bank	169,706	3,361	191,350	8,060

Tirana Bank	1,180,906	4,465	418,616	4,532
United Bank of Albania	1,677	1,677	2,397	2,397
Credit Bank of Albania				
Alpha Bank – Albania	-	-	21,087	3,091
Union Bank	96,507	2,880	107,945	3,866
First Investment Bank	1,113	2,467	4,727	4,727
WVP-INVEST	-		32,518	-
Totali i mjeteve monetare dhe depozitave me bankat	5,318,215	126,816	5,387,951	78,906

Kompania ka bërë investime gjatë viteve në krijimin e filialeve të saj në Sigal Kosove dhe Sigal Maqedonia e Veriut, po kështu në Sigal Life Shqipëri, Kosovë dhe Maqedonia e Veriut. Këto Shuma nuk kanë ndryshime nga viti 2021 dhe në fund të vitit 2023 paraqiten si më poshtë:

Investime ne Pjesemarrje		
Emertimi	31.12.2023	31.12.2022
Investimi ne SIGAL Non Life - Kosove , NETO	554,408,985	554,408,985
Investimi ne SIGAL Life - Kosove	491,728,000	491,728,000
Investimi ne Unqia Ad - Maqedoni	488,040,000	488,040,000
Investimi ne Unqia Life Ad - Maqedoni	369,999,000	369,999,000
Investimi ne Sigal Life - Albania	318,874,000	318,874,000
Total	2,223,049,985	2,223,049,985

Shtesat e paksimet e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara janë regjistruar drejtë e saktë. Edhe llogaritja e amortizimit vjetor të aktiveve është bërë brenda normave të miratuara për secilin lloj të aktivitetit të trupëzuar dhe patrupëzuar dhe gjendja në fund rakordon me listat analitike të tyre. Levizjet e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara me gjëndjet e tyre në fillim të vitit, lëvizjet gjatë vitit dhe gjëndjet në fund të vitit bruto dhe neto, së bashku me amortizimin, janë si pasqyra më poshtë:

Levizjet	Toka	Ndertesa	Mjete Motorrike	Kompjtuera dhe pajisje zyre	Përmirësime të objekteve me qira	Total
Kosto						
Më 31 dhjetor 2021	82,853	1,379,742	174,879	415,779	38,053	2,091,307
Shtesa	-	55,407	3,643	35,374	-	94,424

Nxjerrje jashtë përdorimit	-	(11,000)	(10,200)	(1,991)	-	(23,192)
Më 31 dhjetor 2022	82,853	1,424,149	168,322	449,162	38,052	2,162,539
Shtesa	-	57,539	51,918	11,719	-	121,176
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	(58,706)	(22,227)	(37,806)	-	(118,740)
Më 31 dhjetor 2023	82,853	1,422,982	198,012	423,074	38,052	2,164,975
Amortizimi i akumuluar						
Më 31 dhjetor 2021	-	(571,162)	(126,586)	(328,268)	(29,281)	(1,055,297)
Shpenzimi i vitit	-	(113,897)	(10,016)	(21,730)	(3,805)	(149,449)
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	10,379	9,224	1,695	-	21,298
Më 31 dhjetor 2022	-	(674,680)	(127,378)	(348,303)	(33,087)	(1,183,448)
Shpenzimi i vitit	-	(109,180)	(11,800)	(21,915)	(3,805)	(146,699)
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	28,332	17,643	34,451	-	80,426
Më 31 dhjetor 2023	-	(755,528)	(121,535)	(335,767)	(36,892)	(1,249,721)
Vlera kontabël neto						
Më 31 dhjetor 2021	82,853	808,581	48,293	87,511	8,771	1,036,010
Më 31 dhjetor 2022	82,853	749,469	40,944	100,858	4,965	979,091
Më 31 dhjetor 2023	82,853	667,454	76,478	87,308	1,160	915,254

Gjate vitit 2023 kemi nje ulje të debitorëve police mbajtes dhe nga agjentet në krahasim me vitin 2022 për vlerën 11,723,000 Leke. Gjendja analitike e llogarisë “të arkëtueshme nga sigurimi dhe tjera” paraqitet si më poshtë:

Llogari të Arkëtueshme të sigurimit (ne 000 Leke)	Viti 2023	Viti 2022
Të Arketueshme nga kliente police mbajtes	407,523	417,080
Të Arketueshme nga Ndërmjetës Agjente	2,634	4,801
Shuma	410,157	421,880
Kosto te Marrjes ne Sigurim per tu shperndare	Viti 2022	Viti 2021
Kosto te Marrjes ne Sigurim per tu shperndare (DAC)	409,725	449,517

Përlllogaritjet për përcaktimin e tatim fitimit të vitit 2023, për llogari të organeve të tatim taksave janë bërë drejtë, duke përjashtuar shpenzimet e panjohura. Pasi është bërë ky veprim më tej është llogaritur tatimi i fitimit në masën 15% konformë ligjit në fuqi.

Përlllogaritjet e bëra janë si më poshtë:

PL (në 000 Lekë)	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
Prime të shkruara bruto	5,499,080.52	5,218,347.31
Ndryshimi në rezervat e primeve të pafituara	(166,264.42)	(170,520.45)
Primet bruto te fituara	5,332,816.10	5,047,826.87
Prime të ceduara në risigurim	(966,819.19)	(841,141.38)
Ndryshimi në risigurim në rezervat e primeve të pafituara	33,905.72	(42,875.53)
Të ardhura neto nga primi i sigurimit	(932,913.47)	(884,016.92)
Të ardhura të tjera	75,514.36	147,229.01
Të ardhura neto	4,475,416.99	4,311,038.96
Ndryshimi në rezervat e dëmeve të sigurimit	(256,005.35)	(50,371.63)
Ndryshimi në pjesëmarrjen e risigurimit ne rezervën e dëmeve	(38,464.46)	(18,808.33)
Dëme të paguara	(1,384,548.28)	(1,572,722.85)
Dëme të paguara të risiguruara	113,159.34	179,246.01
Dëme të sigurimit neto	(1,565,858.76)	(1,462,656.80)
Kostot e marrjes në sigurim	(862,901.42)	(839,151.12)
Shpenzime administrative	(1,168,173.50)	(1,178,656.20)
Shpenzime të tjera sigurimi	(163,149.32)	(142,938.32)
Fitimi operativ	715,333.98	687,636.53
Të ardhura nga investimet	162,398.40	118,636.91
Shpenzim interesi qira	(6,662.38)	(8,360.19)
Fitime/Humbje nga kursi i këmbimit	(478,598.89)	(234,290.96)
	(322,862.87)	(124,014.24)
Fitimi para tatimit	392,471.11	563,622.30
Shpenzime për tatimin mbi fitimin	(58,760.32)	(96,785.31)
Fitimi i vitit	333,710.79	466,836.98
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-

Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit	333,710.79	466,836.98
---	-------------------	-------------------

Bazuar në të gjithë treguesit financiar të mbyllur në fund të vitit 2023 dhe duke bërë një analizë financiare të tyre, si departament auditit vërejmë se Kompania Sigal Uniqa Group Austria plotëson kriteret dhe ka një marzh të aftësisë paguese. Niveli i Marzhit të aftësisë paguese është 1,776,152.627 Lekë sipas tabelës më poshtë:

MARZHI I AFTESISË PAGUESE (ne 000 Leke)	2023	2022
a) Shkalla e kërkuar e marzhit bazuar në primet	816,878.3	735,412.1
b) Shkalla e kërkuar e marzhit bazuar në demet	359,356.1	323,668.5
Maksimale midis Shkalles se kërkuar e marzhit të bazuar në primet dhe demet	816,878.3	735,412.1
b) Niveli aktual i marzhit të aftësisë paguese:		
Kapitali aksionar i paguar (shënimi 20)	2,232,909.0	2,232,909.0
Rezerva të rrezikut të sigurimit	260,495.9	260,495.9
Fitimet e mbartura	1,973,283.9	1,939,573.1
Investimet ne filiale	(2,223,050.0)	(2,223,050.0)
Aktive te tjera te zbritshem ne llogaritjen e kapitalit	(467,486.2)	(565,025.8)
Niveli aktual i marzhit të aftësisë paguese	1,776,152.6	1,644,902.3

E njëjta gjë mundet të thuhet edhe për nivelin financiar në funksion të mbulimit të aktiveve, ku nga analiza e bërë rezulton në masën 128,77 %, shifër kjo optimale që reflekton gjëndjen financiare të Kompanisë Sigal Uniqa Group Austria. Pasqyra më poshtë na jep këto përlllogaritje:

Rezervat teknike bruto 31 dhjetor 2023 (ne 000 Leke)			
(A) 5849151.493			
	Limiti i investimit si përqindje e provizionit bruto	Shuma e investimit limit sipas rregullores	Aktive për mbulimin e detyrimeve te sigurimit
Tokë dhe ndërtesa	0.30	1,754,745.45	628,840.71
Depozita me afat (duke përjashtuar fondin e garancisë)	Pa limit	-	4,451,398.74
Investime në bono thesari (duke përjashtuar fondin e garancisë)	Pa limit	-	-

Llogari të arkëtueshme nga risigurimi (klasifikimi mbi BBB)	Pa limit	-	827,706.18
Tituj të tregtuar në tregje të rregulluara	0.35	2,047,203.02	669,620.18
Të arkëtueshme nga sigurimet dhe të tjera të arkëtueshme (më pak se 3 muaj)	0.02	499,537.62	214,662.37
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	0.03	175,474.54	127,495.59
Investime në aktive fikse të ndryshme nga toka dhe ndërtesat	0.05	292,457.57	163,787.22
Interes i llogaritur	0.05	292,457.57	49,309.21
Shpenzime të parapaguara	0.15	399,592.90	399,592.90
Totali (B)			7,532,413.09
Niveli i mbulimit të aktiveve në përqindje			
për mbështetjen e detyrimit të sigurimit		B/A	128.78%

Aktuaristikë - Statistika.

Në kompani llogaritja e rezervave të domosdoshme të saj ka rëndësi të veçantë. Këto llogaritje nga departamenti aktuaristikë-statistikës janë bërë drejt dhe saktë, konformë të gjitha ligjeve, urdhëresave të Autoritetit Mbikqyres Financiar dhe rekomandimeve të dhëna nga ana e Uniqa Group Austria. Janë bërë miratimet e llogaritjeve të tyre me shumat përkatëse, në autoritetet brenda vendit dhe tek Uniqa Group siç përmendëm më sipër, dhe më tej janë përfshirë në bilancin financiar të Kompanisë. Për vitin 2023 rezervat e llogaritura sipas llojit të tyre, krahasuar edhe me vitin 2022 si dhe konformë standarteve të kërkuara janë si më poshtë:

Rezervat (ne 000 Leke)	Viti 2023	Viti 2022
Rezerva për dëme	3,185,199	2,929,194
Rezerva për primet e pafituara	2,663,953	2,497,688

Departamente të tjera në Kompani.

- **Departamenti I Regresit** ka ndjekur gjatë gjithë vitit gjyqet në të cilat Kompania jonë kërkon rimbursimin e vlerës së shkaktarit, paguar të demtuarit. Këto ndiqen pasi pala që ka shkaktuar dëmin ka qënë në kushtet që nuk ka patur sigurim ose në rrethanat që ka dalë me testin e alkoolit mbi normat e lejuara ose i pa pajisur me lejen e drejtimit të mjetit. Këto raste janë ndjekur me

përpikmëri nga ana e departamentit regresit në bashkëpunim edhe me departamentet e dëmeve. **Departamenti Ligjor** ka ndjekur me korrektesë procese gjyqësore ku në raste të caktuara klientë të ndryshëm kanë pretendime karshi kompanisë për vlerën e paguar të demit.

Departamenti ka përgatitur urdhëra dhe udhëzime bazuar në legjislacionin në fuqi për departamentet e tjera të kompanisë, sipas funksionit të tyre për të përmirësuar ecurinë e punës në vazhdimësi. Këto urdhëra në shumicën e rasteve pregatiten me kërkesën e Drejtorit të Përgjithshëm lidhur me zbatimin e disa kushteve e kërkesave në funksion të Kompanisë.

Nga Departamenti Ligjor përgatiten të gjitha materialet për mbledhjet e Këshillit Administrativ, për të gjitha çështjet që do të trajtohen në mbledhjet që bëhen gjatë vitit.

Trajtimi i dëmeve në Kompaninë Sigal Uniqa Group Austria bëhet me disa organizime pune të ndryshme. Kështu për dëmet motorrike Tpl Materiale dhe Kasko të cilat janë në një numër edhe më të madh janë departamente të veçanta për trajtimin e secilit produkt. Në këto departamente bëhet trajtimi i të gjitha dosjeve për klientet e dëmtuar me këto lloj sigurimi. Ne kemi bërë kontrollin e dosjeve të dëmeve me zgjedhje gjatë vitit dhe kemi vërejtur se ato përmbajnë të gjithë dokumentacionin e kërkuar me udhëzime të veçanta për të bërë pagesën e një dëmi. Llogaritjet e vlerave janë bërë sipas manualeve të përcaktuara për këtë qëllim dhe janë paraqitur saktë në sistemin e brendshëm dhe pasqyrat excel.

- Dosjet për dëmet shëndetësore të shkaktuara nga personat me sigurimin Tpl trajtohen në departamentin e organizuar nga Kompania specifikisht për këto dëme. Në përbërje të departamentit ka inxhinier të licensuar, mjekë dhe jurist të cilët përcaktojnë shkallën e dëmtimit të aksidentuarit. Edhe në këto dosje ndodhet i gjithë dokumentacioni i kërkuar sipas udhëzimeve të dërguara.

- Dëmet e shkaktuara nga të siguruarit me karton jeshil përgatiten nga departamenti i cili mbulon specifikisht këto dëme. Nga ky departament bëhet e gjithë korrespondenca me të gjitha byrotë e sigurimit, apo në raste të veçanta me kompanitë e sigurimit jashtë territorit të Shqipërisë. Pas plotësimit të dosjes me korrespondencën e kërkuar dhe dokumentacionin që duhet bëhet edhe pagesa e saj. Departamenti veç rasteve të dëmeve me produktin karton jeshil, ka një sektor që plotëson edhe dëmet e dërguara nga Byroja Shqiptare e Sigurimit për rastet kur shkaktari i dëmit rezulton i pasiguar. Të gjitha të dhënat për pagesat e dëmeve të bëra gjatë vitit 2023 nga ana e jonë janë dhënë në pasqyrat më sipër tek departamentet e marrjes në sigurim. Në të gjithë këto

departamente kemi vërejtur që të dhënat hidhen rregullisht në regjistrat përkatës. (Ka një program kompjuterik të quajtur ICMS për këtë qëllim). Të dhënat janë të azhornuara gjatë gjithë kohës, janë hedhur sipas formateve të miratuara si nga Autoriteti Mbikqyres Financiar edhe nga Uniqa Group Austria.

- Dëmet në departamentin e shëndetit ndiqen nga një sektor i veçante në këtë departament i cili merret vetëm me hapjen e plotësimin e dosjeve për klientet e siguruar me shëndet privat kryesisht, por edhe kur ka raste të shëndetit në udhëtim dhe aksidenteve. Kompania Sigal Uniqa Group Austria ka lidhur kontrata me disa nga spitalet dhe klinikat private që funksionojnë në vendin tonë dhe ku klientet e siguruar kryejnë vizitat mjeksore apo kurohen nga sëmundje të ndryshme. Për secilin klient të siguruar është hapur një dosje e veçantë, në të cilën gjenden të gjitha faturat e lëshuara nga spitalet apo klinikat mjeksore. Bazuar në llojin e sigurimit ka mjaft klientë të cilët këto vizita apo mjekime i kryejnë në shtete të huaja jashtë Shqipërisë, dhe për këto veprohet njëlloj si rastet që thamë për brenda vendit.

- Dëmet e ndodhura dhe të paguara në rastet e sigurimit të pasurisë trajtohen po brenda departamentit të pasurisë, edhe këtu është krijuar një sektor i veçantë që merret me dëmet e ndodhura në këtë departament. Departamenti i dëmeve të Pasurisë gjatë vitit 2023 ka pasur volum normal pune.

- **Departamenti Marketingut** në vlerësimin tonë gjatë vitit 2023 ka punuar mirë dhe duke dhënë një ndihmesë për departamentet e marrjes në sigurim. Kjo gjë është bërë e mundur me anë të reklamave të dhëna në televizionet më të ndjekura në vend, në gazetatat dhe revistat e njohura, rrjetet sociale, si dhe në evenimentet kulturore e sportive të zhvilluara gjatë vitit. Janë përgatitur fletë palosje për reklamimin e punës në fushën e sigurimeve të Kompanisë, në mënyrë që klientët ta kenë më të lehtë perceptimin dhe rëndësinë që ka sigurimi i vetvetes, familjes tij si dhe i aseteve. Është shtrirë veprimtaria reklamave dhe marketingut edhe në rrjetet e ndryshme sociale. Është punuar edhe në pajisjen e të gjitha zyrave ku operon Kompania Sigal Uniqa Group Austria me vendosjen e reklamave të duhura, uniformë në të gjithë rrjetin e shitjes në Kompani. Bëhen trajnime të vazhdueshme me stafin e Kompanisë.

- **Departamenti IT**, si për pjesën e mirëmbajtjes së rrjetit, kompjuterave etj., edhe në krijimin e programeve të reja për përmirësimin e cilësisë së punës në Kompani ka punuar mirë. Janë bërë dhe funksionojnë programet për blerjen e shumë produkteve të sigurimit që Kompania shet në formën

on-line për ta lehtësuar sa më shumë klientin. Ne të njëjtën gjë është punuar edhe për shitjet on-line nga të gjitha zyrat e Kompanisë në të gjithë territorin e vendit tonë. Një punë e mirë e me vlera është edhe vënia në funksion dhe perfeksionimi në departamentin e financës të programit të ri SAP.

Vazhdimisht në këtë departament punohet për përsosjen më tej me të gjitha të rejat që dalin në fushën e programimit të të gjitha programeve ekzistuese në Departamentet e Kompanisë, apo vendosjen e programeve të rinj pune ku në departamente nuk ka të tilla. Të gjitha programet e reja shoqërohen me trajnime të vazhdueshme të stafit për një punë të saktë e rigorozë.

Të tjera.

- Ligji nr.9917, date 19.05.2008 “Per Parandalimin e Pastrimit te Parave dhe Financimit te Terrorizmit”, i ndryshuar me ligjin 10391, date 03.03.2011 dhe ligjin 66/2012, datë 07.06.2012 si dhe udhezimi nr.28, date 31.12.2012 “Për Metodrat dhe Proçedurat e Raportimit dhe Marrjes së Masave Parandaluese në zbatim të ligjeve më sipër, rregullorja nr.58, datë 30.06.2015 e Autoritetit Mbikqyres Financiar “Mbi masat e Vigjilencës së Duhur dhe të Zgjeruar” nga ana e Kompanisë Sigal Uniqa Group Austria kanë gjetur zbatim përgjatë gjithë vitit 2023.

Është bërë përgatitja periodike e materialeve, te rrisht profilit të Kompanisë, të klienteve, si dhe monitorimi i klienteve me risk të lartë, mbi baza mujore. Ka bashkëpunim me departamentet e marrjes në sigurim, të financës dhe atij ligjor për realizimin e këtyre të dhënave. Bëhen rregullisht raportimet CRS me bazë vjetore konformë ligjit 4/2020 “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare” pranë Drejtorisë Përgjithshme të Tatimeve. Bëhen rregullisht raportimet vjetore për Autoritetin Mbikqyrës Financiar konformë anekseve nr 4 dhe 5 te rregullores nr 58/2015 që përmendëm më sipër.

Ndiqet rregullisht, kur ka raste, proçesi identifikimit të klienteve me rrisht të lartë. Në bashkëpunim me departamentin ligjor në Kompani janë hartuar rregullore, udhëzime dhe urdhëra të brendshëm “Për parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”. Janë bërë raporte në periudha të caktuara për mbledhjet e Këshillit Administrativ të Kompanisë për informim ndaj këtyre problemeve. Plotësohen rregullisht materiale të kërkuara si nga ana e Drejtorisë Parandalimit Pastrimit të Parave dhe Uniqa Group Austria. Shënime të mbajtura për klientët (në

rastet kur ka dhe evidentohen) me rrisht të lartë raportohen pranë organeve të autorizuar për këtë qëllim.

Ka një koordinim të punës për të gjitha çështjet e pastrimit të parave midis Sigal Uniqa Group Austria, Sigal Life Uniqa Group Austria dhe Fondit të Pensioneve Sigal Life Uniqa Group Austria, për raportet dhe raportimet që do të bëhen rregullisht gjatë vitit. Gjatë çdo jave bëhet kontrolli i listave të publikuara nga Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave. Hartohet një plan pune trajnimi dhe zbatimi i tij gjatë vitit për të gjithë punonjësit të cilët janë të përfshirë në punën e tyre me çështje të parandalimit të pastrimit të parave.

- **Administrimi i rrezikut** nga rrishtet në Kompani ka qënë në qendër të vëmendjes gjatë gjithë vitit 2023. Këtë e tregon edhe fakti i krijimit të një Këshilli Vlerësues për të ndjekur e raportuar në vazhdimësi problemet që dalin gjatë aktivitetit të sigurimit në Kompani. Janë analizuar të gjitha kontratat e lidhura të sigurimit me vlera të larta të rrezikut, si në drejtim të rrezikut të primit të sigurimit (si do të vendoset ky prim) edhe të rezervës së llogaritur për këto kontrata në rast rreziku.

Po kështu janë bërë rekomandimet e duhura për lidhjen e kontratave të risigurimit me firma risiguruese të njohura, si edhe me vetë Uniqa Reinsurance Group, për një mbrojtje sa më të sigurtë nga çdo rrezik i mundshëm për Kompaninë në zhvillimin e aktivitetit të saj. Në punën e bërë Këshilli i miratuar për ndjekjen e rrezikut ka patur në qendër të vëmendjes edhe administrimin e rrezikut financiar të mundshëm që mund të ketë Kompania.

Është vlerësuar rreziku i kursit të këmbimit (ndryshimet e kursit të saj) pasi dihet që Kompania Sigal Uniqa Group Austria punon me të tre monedhat si Lekë, Euro dhe Usd. Po kështu është vlerësuar rreziku i normës së interesave bankare (luhatja e tyre) duke operuar në depozitat e saj me banka .Për të gjitha këto probleme Kompania Sigal Uniqa Group ka marrë vazhdimisht udhëzime, informacion të thelluar dhe mbështetje nga Departamenti që punon në këtë veprimtari në Uniqa Group ne Austri, ku edhe Kompania raporton punën e saj në vazhdimësi.

Për të qënë sa më efektive janë përgatitur materiale që i shërbejnë Kompanisë në këtë drejtim: - Hartimi e njohja me materialet mbi politikat e menaxhimit të rrishtit ku përfshihen, cilat janë fushat me rrisht të lartë, reagimi pozitiv që do të bëjë Kompania ndaj ndryshimeve që mund të ndodhin, në raste rreziku si do të veprohet për minimizimin e rrishtit, investimet apo lidhja e kontratave vetëm pasi rrishtet të kuptohen plotësisht.

- Janë bërë të njohura e zbatohen parimet e menaxhimit të rriskut. Ky menaxhim të lehtësojë arritjen e objektivave, të përdoren koncepte sa më të thjeshta dhe të drejtperdrejta, të koordinohen punët sa më mirë midis njësive përgjegjëse, ky menaxhim të jetë sa më transparent e me pjesmarrjen e të gjithë vendim marrësve, të jetë një menaxhim në vazhdimësi të vitit.

- Përcaktohen drejtë kategoritë e rriskut, të cilat Ne i përmendëm edhe më sipër.

- Ndiqen proceset në menaxhimin e rriskut. Analiza që bëhet si ka qenë ky proces në vitet e kaluara dhe çfarë masash duhet të merren për të mos ndodhur në të ardhmen. Bëhen analiza herë pas here se në çfarë niveli të rriskut ndodhet departamenti, apo Kompania në një fazë të caktuar.

- Raportimet periodike bëhen në Këshillin Administrativ. Në raporte theksohet apo vihen në dukje problemet e diskutuara, rreziqet e lartë, etj.

- **Risku i përputhshmërisë** përfaqëson probabilitetin e krijimit të efekteve negative mbi pozicionin e shoqërisë për shkak të mos-zbatimit të rregulloreve, kryesisht të atyre që rregullojnë nivelin e saj të kapitalit dhe parandalimin e pastrimit të parave. Departamenti i Auditit të Brendshëm kontrollon përputhshmërinë me detyrimet e akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse. Shoqëria operon në bazë të ligjit Shqiptar si dhe në baze të rregulloreve dhe udhëzimeve në nivel grupi dhe raportimi lidhur me përputhshmërinë kryhet në UNIQA Group. Pranë shoqërisë është ngritur dhe funksionon Funkzioni (Departamenti) i Përputhshmërisë (Compliance) sipas politikës së përputhshmërisë dhe udhëzimeve të UNIQA, përbërë nga personi përgjegjës (Compliance Officer) dhe zëvendësi (Compliance Deputy), kanë planin e tyre të zbatimit të detyrave, dhe raportojnë periodikisht dy herë në vit pranë funksionit të përputhshmërisë së UNIQA.

Gjatë këtij viti nuk janë evidentuar rreziqe apo mospermbushje domethënëse në kuadër të auditimit të përputhshmërisë. Struktura e compliance është e shtrirë dhe në shoqëritë bija të grupit me një sistem raportin në compliance departament në SIGAL UNIQA Group Asutria sh.a . Çdo shoqëri e zotëruar në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni të Veriut ka një Zv. compliance officer i cili raporton dhe Compliance department në SIGAL UNIQA dhe në Uniqa Group Compliance. Compliance funksion si strukture përbërëse e sistemit të administrimit të rrezikut të ngritur nga shoqëria si Komitet.

Ne, si Auditues të Brendshëm, kryejmë angazhimet tona duke ndjekur parimet e Pavarësisë së Auditit të Brendshëm. Drejtori i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm dhe stafi i kësaj Drejtorie

kanë eksperiencën e duhur dhe në çdo kohë i referohen Ligjit “Për Auditimin e Brendshëm”, Kodit të Etikës dhe standarteve ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm.

Këto ishin problemet dhe puna e bërë në Kompaninë Sigal Uniqa Group Austria për vitin 2023. Periudhën në vazhdim do të vijojmë punën tonë sipas planit të punës të miratuar për vitin 2024, dhe çdo problem do ta shohim e trajtojmë me përgjegjësi. Në rastet që do të mund të konstatojmë parregullsi apo veprime jo konformë ligjeve, udhëzimeve apo urdhërave të dhëna, Ne do të bëjme njoftimet e duhura si për Këshillin Administrativ, Autoritetin Mbikqyrës Financiar si edhe për Uniqa Group Audit.

RAPORT PËR VLERËSIMIN E RREZIQEVE PËR VITIN 2023

Përmbledhje

Përshkrim i provës së rreziqeve të sigurimit dhe rreziqeve të shpenzimeve në sigurimet e Jo Jetës.

KUADRI I ADMINISTRIMIT TË RREZIKUT

Kompania ka ngritur strukturat përkatëse përgjegjëse, të krijuara për të ushtruar funksionin e administrimit të rrezikut me qëllim vlerësimin, pranimin dhe administrimin e rrezikut. Këto struktura janë:

- **Bordi Drejtorëve që përbëhet nga Drejtori Përgjithshëm, Zv. Drejtori i Përgjithshëm, Drejtori i Departamentit të Marrjes në Sigurim**
- **Risk Menaxher Responsible person**
- **Compliance**

1 KATEGORITË E RREZIQEVE

2.1 Rreziqet e sigurimit

- Rritje e UPR.
- Rritje e RBNS
- Rritje e dëmeve të paguara.

2.2 Rreziqet financiare

- Rritje e shpenzimeve operative të kompanisë për arsye të ndryshme.

2 KUADRI I RAPORTIMIT

Metodologjia e miratuar për vlerësimin dhe klasifikimin e rreziqeve dhe kryerjen e provave të rezistencës është:

Llogaritja e nevojave për kapital shtesë në rast se gjatë vitit të ardhshëm, ndodhin të gjithë skenarët e menduar të situatave katastrofike, epidemike dhe të krizave financiare.

Llogaritjet janë bërë mbi bazë skenari.

Më poshtë tregohet si janë zgjedhur skenarët e mundshëm të rrezikut.

3 RREZIQET DHE ADMINISTRIMI I KAPITALIT

4.1 Rreziqet e sigurimeve

Skenari 1: Është supozuar që gjatë vitit të ardhshëm do të ketë një rritje të ndjeshme të frekuencës së dëmeve dhe inflacionit të dëmeve. Të dy këta faktorë do të prekin të gjithë portofolin (të gjitha LoB-et). Mendohet që një situatë e tillë mund të ndodhë 1 herë në 50 vjet (probabilitet 2%). Ndikimi do të jetë:

- Rritje e UPR.
- Rritje e RBNS

Skenari 2: Një katastrofë natyrore që dëmton masivisht pronat e siguruara. LoB i prekur do të jetë portofoli i Zjarrit. Mendohet që do të kemi trefishim të numrit të dëmeve të paguara dhe 2.5-fishim të dëmit mesatar. Një situatë e tillë mund të ndodhë 1 herë në 100 vjet (probabilitet 1%). Ndikimi do të jetë:

- Rritje e dëmeve të paguara për portofolin e Zjarrit.

Skenari 3: Një krizë financiare që sjell mosplotësimin masiv të kontratave. Portofoli i prekur do të jetë portofoli i garancive (ofertë + kontratë). Mendohet që do të paguhen dëme për 19% të të gjitha kontratave në fuqi, me rritje 200% të dëmit mesatar. Një situatë e tillë mund të ndodhë 1 herë në 100 vjet (probabilitet 1%). Ndikimi do të jetë:

- Rritje e dëmeve të paguara për portofolin e Garancive.

Skenari 4: Epidemi masive që sjell sëmundshmëri në nivele të larta. Portofoli i prekur do të jetë Shëndeti. Mendohet që do të paguhen dëme për 22% të të gjitha kontratave në fuqi, me rritje 400% të dëmit mesatar. Një situatë e tillë mund të ndodhë një herë në 100 vjet (probabilitet 1%). Ndikimi do të jetë:

- Rritje e dëmeve të paguara për portofolin e Shëndetit.

Skenari 5: Një krizë financiare që sjell mosplotësimin masiv të kontratave. Portofoli i prekur do të jetë portofoli i Mallit në Transport. Mendohet që do të paguhen dëme për 10% të të gjitha kontratatave në fuqi, me 110% rritje të dëmit mesatar. Një situatë e tillë mund të ndodhë 1 herë në 100 vjet (probabilitet 1%). Ndikimi do të jetë:

- Rritje e dëmeve të paguara për portofolin e Mallit në Transport.

4.2 Rreziqet financiare

Skenari 6: Rritje me 10% e shpenzimeve operative të kompanisë për arsye të ndryshme. Kjo nuk përfshihet në Rreziqet e Sigurimit.

4.3 Kërkesat për kapital për një rritje të rezervave për primin e pafituar (KKupr) (Skenari 1)

Në këtë rezervë ka dy rreziqe: Rreziku Parametrik (Parametër) dhe Rreziku i luhatjes (volatility).

4.3.1 Rreziku parametrik

Periodha mesatare e rrezikut të mbetur është marrë 6 muaj. Frekuenca e dëmeve është menduar se do të rritet me 10% në vit dhe inflacioni i dëmeve do të rritet me 2% në vit.

Kërkesa për kapital për efekt të rrezikut parametrik llogaritet:

$$KKpar = (f + i) \times \frac{6}{12} \times UPR \quad (1)$$

f = frekuenca

i = inflacioni

4.3.2 Rreziku i luhatjes (volatility)

Rreziku i luhatjes, paraqet pasigurinë mbi ecurinë e biznesit për periudhën për të cilën është mbajtur rezerva UPR.

Kërkesat për kapital për rrezikun e luhatshmërisë llogaritet:

$$KKvol = 2.58 \times \sqrt{\frac{n}{2}} \times m \times \sqrt{1 + v^2} \quad (2)$$

n = numri i pritshëm i dëmeve për vitin e ardhshëm

m = dëmi mesatar i pritshëm për vitin e ardhshëm

v = koeficienti i variacionit të shpërndarjes së dëmeve për vitin e ardhshëm

Kërkesa për kapital për rritje të UPR si pasojë e dy rreziqeve të mësipërme është:

$$KKupr = \sqrt{KKpar^2 + KKvol^2} \quad (3)$$

4.3.3 Kërkesat për kapital për rritje të rezervave (KKrez)

Për rezervat, faktorët e rrezikut janë dëmi mesatar, inflacioni i dëmeve dhe historiku i pagesave. Nëpërmjet llogaritjes së devijimit standard (S) synohet të matet UNCERTAINTY.

Për një LoB, devijimi standard llogaritet si më poshtë:

$$Slob = \max [1 - 2 \times c; 0.7 \times (1 - c)] \times \min \left(u \times \frac{\sigma}{\sqrt{a}}; 0.5 \times f \right) \quad (4)$$

c = pjesa e ceduar në risigurim (llogaritet si raporti ndërmjet shpenzimeve të risigurimit me primet e shkruara.

u = dëmet e paguara

σ = devijimi standard

a = pjesa e LoB brenda kompanisë. Llogaritet si raporti i primeve të LoB me primet e kompanisë

f = rezervat për dëmet pezull

p_{kom} = primet e kompanisë

P_{lob} = primet e LoB

Totali për kompaninë:

$$S = \sqrt{\sum Slob^2} \quad (5)$$

Kërkesat për kapital llogariten:

$$KKrez = 2.58 \times S \quad (6)$$

4.3.4 Kërkesat për kapital për rrezikun e katastrofave (KKkat) (Skenari 2 – 5)

Kërkesat për kapital llogariten:

$$KKkat = \sqrt{\sum_{i=1}^4 kat_i^2} \quad (7)$$

Nevojat e përgjithshme për kapital për rrezikun e sigurimit janë:

$$KKins = \sqrt{KKrez^2 + KKupr^2 + 2 \times 0.5 \times KKrez \times KKupr + KKkat^2} \quad (8)$$

4.3.5 Kërkesat për kapital për rrezikun e shpenzimeve (KKexp) (Skenari 6)

Qëllimi është që të provohet rreziku i rritjes së shpenzimeve, për arsye të ndryshme me 8%. Mendohet që një situatë e tillë mund të ndodhë një herë në 50 vjet (probabilitet 2%).

$$KKexp = 0.08 \times SHP \quad (9)$$

4 PLANET E VIJUESHMËRISË SË VEPRIMTARISË DHE PËRBALLIMIT TË SITUATAVE TË PAPANASHIKUARA.

Për të siguruar vijueshmërinë e veprimtarisë, për të përballuar situatat e parashikuara më sipër, për të rifilluar veprimtarinë pasi rreziqet e mësipërme të jenë materializuar apo ngjarjet me efekt të dëmshëm të kenë ndodhur, kompania ka marrë masat për sigurimin e kapitalit shtesë që do të nevojitet për këtë qëllim.

Rezultatet e testimeve janë si më poshtë:

Kërkesa për kapital shtesë është:

		EURO
KKupr		1,228,901
	KKpar	1,202,599
	KKvol	252,893
KKrez		6,130,138
KKkat		5,122,823
	KKkat1	241,674
	KKkat2	5,063,092
	KKkat3	263,334
	KKkat4	693,301
KKins		8,536,125
KKexp		1,879,651

KKtotal	10,415,777
----------------	-------------------

5 REKOMANDIMET DHE MASAT

Strukturat përkatëse përgjegjëse, të krijuara për të ushtruar funksionin e administrimit të rrezikut me qëllim vlerësimin, pranimin dhe administrimin e rrezikut, raportojnë periodikisht për rreziqe me vlerë të madhe, që mund të ndikojnë në aktivitetin e ardhshëm të kompanisë.

6 PËRFUNDIMI

I marrë veçmas, secili skenar mund të ndodhë një herë në 50 vjet (probabilitet 2%) ose një herë në 100 vjet (probabilitet 1%). Në përgjithësi, probabiliteti që të ndodhin të gjithë skenarët brenda vitit të ardhshëm, është shumë i vogël (i papërfillshëm). Kompania ka marrë masat për sigurimin e kapitalit shtesë që do të nevojitet për këtë qëllim.

DISA TREGUES PËR SIGAL UNIQA JO-JETË, VITI 2023


Treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit	145%
Treguesin e likuiditetit	2.8
Treguesit në mbulimin e provigjioneve teknike	129%

Objektivat e Grupit 2024

BUXHETI PER VITIN 2024	
në 000 EURO	
Janar	10,953
Shkurt	21,907
Mars	32,860
Prill	43,814
Maj	54,767
Qershor	65,720
Korrik	76,674
Gusht	87,627
Shtator	98,581
Tetor	109,534
Nentor	120,487
Dhjetor	131,441
Viti	131,441

GRUPI

BUXHETI PER VITIN 2024 në 000 EURO



Pjesëmarrje të Shoqërisë në kapitalin e shoqërive të tjera

Shoqëria SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a është aksioneri kontrollues i Grupit SIGAL

ku zotëron:

- 99,99 % të aksioneve të shoqërisë SIGAL LIFE UNIQA Group Sh. A.
- 100 % të aksioneve të shoqërisë SIGAL UNIQA Group ASUTRIA Sh.A. Kosovë
- 100 % të aksioneve SIGAL LIFE UNIQA Group AUSTRIA Sh.A. Kosovë
- 99.99 % të aksioneve të UNIQA AD Skopje në Maqedoninë e Veriut
- 100 % të aksioneve të UNIQA Life AD Skopje në Maqedoninë e Veriut.

Sistemi qeverisës i Shoqërisë Parimi

Sistemi qeverisës bazohet në parimin e administrimit të sigurtë dhe të kujdesshëm të veprimtarisë, në përputhje me natyrën, vëllimin dhe nivelin e kompleksitetit të veprimtarisë së biznesit, nepermjet nje ndarje të përshtatshme dhe caktim të qartë të përgjegjësive ndermjet strukturave te brendshme te kompanise.

Baza ligjore

Shoqëria ekaorganizuar sistemin qeverisës duke u bazuar në legjislacionin vendor, Statutin e Shoqërisë si edhe standardet e udhëzimet e aksionarit Austriak UNIQA Osterreich Versicherungen.

Struktura qeverisëse

Në përputhje me parashikimet ligjore, struktura qeverisëse e Shoqërisë është e organizuar sipas sistemit me dy nivele.

Organet e Shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve
- Këshilli Mbikqyrës
- Bordi Drejtues
- Komiteti i auditimit
- Njësia e Auditit të Brendshëm
- Komiteti i Administrimit të Rrezikut
- Përputhshmëria dhe Ligjori
- Aktuaristika
- Strukturat e tjera operacionale

Organigrama (bashkanigjitur në faqen e mëposhtme)

Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve

Aksionerët ushtrojnë të drejtat e tyre në Asamblesë të Përgjithshme në përputhje me parashikimet ligjore përkatëse.

Asambleja e Përgjithshme mbledhet një herë në vit për mbledhje të zakonshme të asamblesë.

Asambleja mbledhet në mbledhje të jashtëzakonshme të asamblesë nëse kërkohet.

Përgjegjësitë kryesore të Asamblesë janë:

- Ndryshimi i Statutit të Shoqërisë
- Zgjedhja / shkarkimi i Anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës dhe anëtarëve të Bordit Drejtues (Administratorit të Përgjithshëm)
- Zgjedhja e auditorit të jashtëm
- Vendime të lidhura me kapitalin
- Miratim bilanci
- Vendimi për shpërndarjen e fitimit.

Aksionerët e Shoqërisë janë:

- UNIQA Österreich Versicherungen 86,9 % të aksioneve
- Avni Ponari 10 % të aksioneve
- Edvin Hoxhaj 3,07% të aksioneve

Këshilli Mbikqyrës

Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës janë:

- Andreas Brandstetter, Kryetar
- Wolfgang Kindl, Anëtar
- Vinzenz Benedikt, Anëtar
- Georgios Bartzis, Anëtar
- Gerald Müller, Anëtar

Këshilli mbikëqyr Bordin Drejtues të Shoqërisë dhe mblidhet rregullisht çdo tre muaj.

Përgjegjësitë kryesore të Këshillit Mbikqyrës janë:

- mbikqyrja e veprimtarisë së Shoqërisë
- miratim i Njesise se Auditit te Brendshem dhe Komitetit te Auditimit
- miratim i raporteve te Njesise se Auditit te Brendshem dhe te Komitetit te Auditimit
- miratimi i rregulloreve të brendshme dhe procedurave të shoqërisë
- miratimi i rezolutave të Asamblesë së Përgjithshme

Bordi Drejtues

Përgjegjësitë kryesore të Bordit Drejtues janë:

- përfaqësimi i Shoqërisë në marrëdhënie me palë të treta
- administrimi i veprimtarisë së Shoqërisë
- raportimi në Këshillin Mbikqyrës
- çdo çështje tjetër sipas Statutit të Shoqërisë.


Bordi Drejtues i Shoqërisë përbëhet nga:

- Avni Ponari, Administrator i Përgjithshëm


Drejtuesit kryesorë të Shoqërisë janë:


- Alma Totokoçi, Zv.Drejtor i Përgjithshëm
- Ilir Halilaj, Zv.Drejtor i Përgjithshëm, Trajtimi i dëmeve
- Ditika Kruja, Drejtor Departamenti Kartonit Jeshil/ FK
- Klement Mersini, Drejtor Departamenti i Financës
- Abdyl Sarja, Sekretar i Përgjithshëm, Dr. Dept. Ligjor, Pajtueshmerise dhe HR
- Arben Çavolli, Drejtor Departamenti i Aktuaristikës
- Rugova Çokaj, Drejtor Njesia e Auditit të Brendshëm
- Mustafa Sallaku, Drejtor Departamenti IT
- Besnik Çobaj, Drejtor Departamenti i Marrjes ne Sigurim Motorrike
- Ogert Shkrepa, Drejtor Departamenti i Pasurisë dhe Garancive
- Milena Merjemaj, Drejtor Departamenti i Shëndetit Privat
- Gentjan Trenova, Drejtor Departamenti i Dëmeve Shëndetësore MTPL
- Ermal Ponari, Drejtor Departamenti i Dëmeve Materiale MTPL
- Florant Lumani, Drejtor Departamenti Kasko
- Kristjan Prela, Menaxher Departamenti i Regresit

STRUKTURA E GRUPIT SIGAL UNIQA



SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA NON LIFE STRUCTURE







Drejtoria e përgjithshme / Head Office
Blv. "Zogu I", Nr. 1, Tirana - Albania, Tel. (+355) 4 2233 308,
e-mail: info @sigal.com.al

Tiranë 1
Blv. "Zogu I", pll. Diplomatëve, nr. 57, Tel. (+355) 2233 308

Tiranë 2
Rr. "Ukraina e Lirë", pas Kullave Binjake
Tel. (+355) 44 511 666

Tiranë 3
Blv. "Gëjrgj Fishta", Komplekti Delijorgji
Tel. (+355) 44 330 171

Tiranë 4
Blv. Dëshmorët e Kombit, Piramida, Njësia BE4
Tel. (355) 68 40 81979

Tiranë 6
Rr. "Sotir Caci", pranë Freskut, Tel. (355) 67 201 2309

Tiranë 7
Rr. "Teodor Keko", pranë Astir. Tel. (355) 69 409 6371

Berat
L. "28 nëntori", Tel. (+355) 32 234605

Dibër
L. "Nazmi Rushiti", Peshkopi, Tel. (+355) 218 25155

Durrës 1
L. nr. 3, rr. "Skënderbej", qendra e Biznesit
Monun Tel. (+355) 522 31047

Durrës 2
Rr. "Tregtare", Nr.42, Blv. Kryesor, Tel. (+355) 69 365 7105

Elbasan 1
L. "28 Nëntori", Rr. "11 Nëntori", pll.109/1, Kati 2
Tel. (+355) 54 244446

Elbasan 2
L. " Kongresi Elbasanit", Rr. "Baki Kongoli", shatërvani krye-
sor, Tel: (+355) 69 40 96 303

Fier 1
L. "1 Maji", Rr. Jani Bakalli, tek Kupola Center
Tel. (+355) 69 209 3814

Fier 2
L. "Apollonia", blv. "Jakov Xoxa", pll. 1, shk. 4
Tel. (+355) 342 23035

Fushë Krujë
Pallati hark, qendër Tel. (+355) 563 22869

Gjirokastër 1
L. "Punëtore", R r."Nacionale", Tel. (+355) 842 67080

Kavajë
L. nr. 1, Sallbeg. Tel. (+355) 552 42562
Korçë
Blv. "Republika", pranë Kinema Milenium
Tel. (+355) 822 50433

Kukës
L. nr. 5, Te. (+355) 242 24532

Laç
Qendër ,Tel. (+355) 536 4578

Lezhë
L. Besëlidhja, Sheshi Besëlidhja, Tel. 0215 24656

Lushnje
L. "Loni Dhamo", Tel. (+355) 352 21532

Mamurras
Qendër, Tel. (+355) 69 20 25 829

Mat
L. "Partizani", Burrel Tel. (+355) 217 22746

Përmet
Shëtitorja "Odhise Paskali", Tel. (+355) 813 23293

Pogradec
L. Nr 2 Rr, "Rinia", pallati 80, Tel. (+355) 832 26792

Pukë
Rr. "Imer Puka", blloku nr. 1, Tel. (+355) 212 22880

Rrëshen
Sheshi "Abat Doçi", Mirditë Tel. (+355) 69 20 74 581

Sarandë
L. nr. 1, rr. "Flamurit", nr. 19, Tel. (+355) 852 25045

Shkodër 1
L. "Vojo Kushi", Rr. "Çlirimi", pranë teatrit "MIgjeni", Kati II
Tel (+355) 222 44429

Shkodër 2
L. "V.Shanto", Rr."Çajupi", pll. Fishta 2 Tel. (+355) 222 49680

Tropojë
Qendër, Bajram Curri, Tel. (+355) 213 23101

Vlorë
L. Pavarësia, Qendra Tregtare Riviera, Tel. (+355) 332 23121



Drejtoria/Head office
Rr. "Ukshin Hoti" Nr 19 – Pejton, Kat. 4 Prishtine – Kosovë
Tel. (+383) 38 240 241, E-mail: info @sigal-ks.com

Prishtinë
Rr. "Dëshmorët e Kombit", nr. 72/a, Lagja Ulpian
Tel. (+381) 38 550 576

Ferizaj
Rr. "Wiliam Wolker" p.n, Tel. (+381) 290 320 536

Gjakovë
Rr. "E Tiranës" p.n, Tel. (+381) 44 188 354

Gjilan
Rr. "Adem Jashari", Tel. (+381) 280 320 810

Mitrovicë
Rr. "Adem Jashari" p.n, Tel. (+381) 44 263 742

Pejë
Rr. "Mbretresha Teutë" p.n, Tel. (+381) 39 420 092

Prizren
Rr. "William Woker" p.n, Tel. (+381) 29 244 024



Drejtoria / Head office
Bul. Ilinden nr. 1, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut
Tel: +389 2 3288 800, email: info@uniqa.mk

Shkup
Xhon Kenedi, nr. 27,
Tel. (+389) 2 2621 211

Dibër
Bratstvo Edinstvo,
Tel. (+389) 46 835 145

Berovë
Marshal Tito nr. 115,
Tel. (+389) 75 811 801

D. Hisar
Goce Delcev Nr.9A,
Tel. (+389) 47 275 000

Delcevo
Nikola J. Vapcarov,
Tel. (+389) 75 309 005

Gostivar
Dimitar Vlaho,
Tel. (+389) 42 221 046

Gjevgjeli
7 Noemvri,
Tel. (+389) 34 218 568

Prilep
11 Oktomvri Lam.A 8,
Tel. (+389) 48 427 657

Kavadar
Ilidenska nr. 115,
Tel. (+389) 34 400 288

Probishtip
Hristjan T. Karposh,
Tel. (+389) 32 480 860

Kërcovë
Kuzman Jusfovski Pitu,
Tel. (+389) 45 224 290

Radovish
Marsal Tito nr.23,
Tel. (+389) 32 630 309

Koçan
Marshal Tito 86 A,
Tel. (+389) 33 272 150

Strugë
JNA,
Tel. (+389) 46 783 201

Kriva Palanka
Marsal Tito nr.230a,
Tel. (+389) 31 372 182

Strumicë
Mladinska Nr. 45,
Tel. (+389) 34 430 083

Kumanovë
Potok Serava nr. 2,
Tel. (+389) 31 437 187

Shën Nikollë
Ilined,
Tel. (+389) 32 444 045

Manastir
Stalarska,
Tel. (+389) 47 203 646

Shtip
Tosho Arsov nr. 38,
Tel. (+389) 32 389 710

Negotivë
Marshal Tito nr. 43,
Tel. (+389) 43 370 590

Tetovë
Ilindeska, nr. 51,
Tel. (+389) 44 351 630

Ohër
Bul. Turisticka bb zgr. Remis
Kifl a,
Tel. (+389) 46 231 616

Veles
Strasho Pinxhur nr. 6,
Tel. (+389) 32 43 211 806

Prespë
Leninova,
Tel. (+389) 47 453 000

Vinicë
Ilidenska,
Tel. (+389) 33 364 559



ALBANIA

SIGAL Business Center,
Blv. Zogu I, Nr. 1, Tirana, Albania
+355 4 2233 308, info@uniqa.al
sigal.com.al

KOSOVA

Rr."Ukshin Hoti" Nr. 19, Pejton,
Kat. 4 Prishtinë, Kosovë
+383 38 240 241, info@uniqa-ks.com
sigal-ks.com

NORTH MACEDONIA

Bul. Ilinden nr. 1, 1000 Skopje,
North Macedonia
+389 2 3288 800, info@uniqa.mk
uniqa.mk